



INSTITUTI
DEMOKRATIK
I KOSOVËS



DEMOKRATIZIMI
DHE PRAKTIKAT
PARLAMENTARE



RAPORT I MONITORIMIT TË PUNËS SË KUVENDIT PËR VITIN 2016

Prishtinë, prill 2017

COPYRIGHT © 2017. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,

10 000, Prishtinë, Kosovë.

Tel.: +381 (0)38 248 038

E-mail: info@kdi-kosova.org

Ueb: www.kdi-kosova.org

www.votaime.org



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

“Ky botim është realizuar me përkrahjen nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe menxuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)”. Përbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së apo KCSF-së.

PËRMBAJTJA

Përbledhje Ekzekutive.....	4
1. HYRJE.....	6
2. Analiza e Punës së Komisioneve parlamentare	6
2.1 Komisioni për Buxhet dhe Financa.....	8
2.2 Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim.....	9
2.3 Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korruptionit.....	9
2.4 Komisioni për Integrime Evropiane	10
2.5 Komisioni për Punë të Jashtme.....	10
2.6 Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport.....	11
2.7 Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.....	12
2.8 Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor	13
2.9 Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale	13
2.10 Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së.....	14
2.11 Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media	15
2.12 Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike (KMFP)	15
2.13 Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencionit Kosovar për Inteligjencë	16
2.14 Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione	16
2.15 Komisioni Parlamentar për Stabilizim Asociim	16
3. Mbarëvajtja e Seancave Parlamentare	17
4. Përbushja e Agjendës Legjislative.....	20
5. Mbikëqyrja Parlamentare	23
5.1 Pyetjet parlamentare	23
5.3 Mbikëqyrja e institucioneve të pavarura	29
5.4 Interpelancat.....	30
6. Lojaliteti i deputetëve ndaj grupeve parlamentare	30
7. Rekomandimet.....	32
ANEKS 1: Pjesëmarrja e deputetëve në mbledhjet e komisioneve parlamentare	33
ANEKS 2: Pjesëmarrja e deputetëve në seanca	41
ANEKS 3: Pyetjet parlamentare sipas sektorëve.....	46

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë vitit 2016 Kuvendi i Kosovë është ballafaquar me mungesa të shpeshta të kuorumi, si në seanca ashtu edhe në mbledhjet e komisioneve. Miratimi i ligjeve në sesionin vjeshtor pothuajse në asnjëren seancë nuk ka ndodhur në ditën që është planifikuar, por është dashur të shtyhen për një ditë tjeter. Shumica parlamentare dhe koalicioni qeverisës janë treguar të paafta politikisht për të trajtuar disa prej temave më të rëndësishme, siç është Ratifikimi marrëveshjes për përcaktimin e vijës kufitare me Malin e Zi.

Përkundër që ndarja e pushtetive është e garantuar me Kushtetutë, nuk kanë munguar rastet kur pushteti legjislativ ka shfaqur tendenca të hapura për të ndërhyrë në punën e atij gjyqësor. Rasti më i rëndë ka qenë ai i diskutimit të vendimit të Gjykatës së Apelit, që ndër të tjera nuk ka prodhuar as ndonjë debat përbajtjesor.

Gjatë viti, por edhe në përgjithësi Legjislatura e V-të, ka pasur tendenca që të përfshihet në diskutime të politikave ditore, të cilat kanë qenë të gjata dhe nuk kanë prodhuar ndryshim. Në këto debate, shpeshherë situata ka eskaluara në përplasje ndërmjet deputetëve të partive në pushtat me ata në opozitë, duke përdorë gjuhë të ashpër dhe ofenduese, të cilat janë shoqëruar me fyerje dhe akuza të rënda. Kryesuesit e këtyre seanca kanë qenë të dobët, duke lejuar debate të tillë dhe nuk kanë respektuar procedurat e parapara në Rregulloren e Punës së Kuvendit.

Ndonëse bojkoti konsiderohet si një mjet demokratik për të shprehur mospajtimin apo protestën ndaj një çështje apo veprimi të caktuar, kjo gjë është shndërruar në dukuri në Kuvendin e Kosovës. Në sesionin pranveror opozita ka bojkotuar Kuvendin, ndërsa në atë vjeshtor Lista Serbe. Të dy grupet i janë kthyer punës në Kuvend, ndonëse pa u përbushur qëllime te tyre para bojkotit dhe për më të tepër janë kthyer të ndarë.

Praktika e shqyrimit të miratimit të buxhetit të shtetit me procedura të përshpejtura dhe pa konsultime me publikun ka vazhduar edhe në këtë vit.

Ngashëm sikur vitin e kaluar edhe këtë vit, Kuvendi i Kosovës nuk ka pasur performance të mirë në rolin e tij mbikëqyrës. Kjo pasi që gjatë gjithë vitit 2016 janë parashtuar vetëm 174 pyetje parlamentare. Nga pyetjet e parashtuar, përgjigje kanë marrë vetëm 72 prej tyre apo 41%.

Dy interpelanca janë mbajtur gjatë këtij viti, të cilat janë iniciuar nga grupe parlamentare Lëvizja Vetëvendosje të drejtuar Kryeministrit Isa Mustafa.

Gjatë vitit 2016 komisionet parlamentare kanë ftuar për raportim 54 herë ministrat e kabinetit qeveritar. Në sesionin vjeshtor komisionet kanë qenë shumë më aktive në këtë aspekt, periudhë në të cilën janë bërë 72% e raportimit të ministrave. Kjo rritje e numrit të raportimeve të ministrave në komisione ka ardhur kryesisht si rezultat i mos procedimit të projektligeve që komisionet kishin paraparë të shqyrtoton gjatë këtij sesioni, e të cilat Qeveria nuk i ka proceduar për shqyrtim në Kuvend.

Kuvendi gjatë këtij viti ka mbajtur 24 seanca plenare, 7 seanca të jashtëzakonshme dhe 4 seanca solemne. Nëse e krahasojmë me numrin e seancave të mbajtura në vitin 2015, shohim se në vitin 2016 janë mbajtur 9 seanca më pak.

Gjatë vitit 2016 nga 15 komisione dhe një nën-komision sa ka Kuvendi, janë mbajtur gjithsej 362 mbledhje, që është numër më i vogël në krahasim me numrin e mbledhjeve të mbajtura në vitin 2015 për 57 mbledhje.

Sa i përket dëgjimeve publike këtë vit janë mbajtur gjithsej 21, ndërsa në vitin 2015 komisionet kanë mbajtur gjithsej 38 dëgjime publike.

Në vitin 2016, Kuvendi ka zhvilluar punimet pa miratuar një Plan të Punës ashtu siç parashihet me Rregullore. Megjithëkëtë, nga planet e punës së komisioneve, për vitin 2016 janë paraparë të miratohen 141 projektligjeve.

Gjatë vitit Kuvendi ka arritur të miratoi 52 ligje apo 36% të planifikimit. Inicuesi kryesor i projektligjeve mbetet Qeveria me 49 projektligje, 2 Kuvendi dhe 1 iniciativë qytetare. Tetë ligje ishin për plotësim/ndryshim.

Ndërkohe në komisionet parlamentare në procedurë të shqyrtimit kanë mbetur edhe 19 projektligje (13%) ndërsa 70 projektligje (49%) nuk janë përgatitur ende. Edhe këtë vit është përsëritur dukuria e miratimit të ligjeve me procedurë të përshtypjtar, gjë që ka ndodhur në 9 raste. Nëse e krahasojmë numrin e miratimit të ligjeve me vitin 2015, shohim se këtë vite janë miratuar 5 ligje më shumë.

Tema e dialogut për normalizim të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është diskutuar në 6 seanca parlamentare, përderisa deputetët kanë parashtruar vetëm 10 pyetje parlamentare me ketë temë.

1. HYRJE

Raporti i monitorimit të Kuvendit paraqet vlerësimin e punës së Kuvendit për periudhën janar – dhjetor 2016, duke u bazuar në monitorimin sistematik të këtij institucioni. KDI ka përcjellë mbarëvajtjen e punimeve të Kuvendit, si mbledhjet e komisioneve parlamentare, mbledhjet e Kryesisë së Kuvendit dhe seancat plenare si dhe ka analizuar përputhshmërinë e tyre me Rregulloren e Punës së Kuvendit.

Ky raport përmban të dhëna të shumta statistikore të cilat janë analizuar dhe krahasuar me ato të vitit paraprak, për të gjallë një pasqyrë më të qartë të punës së Kuvendit. Pjesa e parë e raportit analizon punën e komisioneve parlamentare, më saktësisht vlerësimin e përbushjes së planeve të tyre të punës. Në detaje janë të renditura për secilin komision të gjitha detyrat që kanë përbushur gjatë kësaj periudhe dhe po ashtu edhe çështjet që kanë mbetur të pa trajtuar. Të dhënat i janë nënshtruar edhe krahasimit me vitin paraprak gjë që ka mundësuar matjen e progresit.

Pjesa e dytë e raportit trajton mbarëvajtjen e seancave, përbushjen e agjendës legislative si dhe dinamikën e miratimit të ligjeve. Hapësirë e veçantë i është dhënë mbikëqyrjes parlamentare. Në raport është përfshirë edhe matja e lojalitetit të deputetëve në relacion me grupin parlamentar. Paraqitja dhe analizimi i udhëtimeve të deputetëve jashtë vendit dhe shpenzimet në tërësi janë përfshirë në këtë raport, pasi që Kuvendi nuk ka publikuar Raportin vjetor të shpenzimeve. Përmes monitorimit të punës së Kuvendit, KDI synon të rrisë efikasitetin, transparencën si dhe llogaridhëni e institucionit më të lartë ligjvënës karshi qytetarëve.

2. ANALIZA E PUNËS SË KOMISIONEVE PARLAMENTARE

Sesioni pranveror kishte nisur me bojkotim të punimeve nga partitë opositare, gjë që ka ndikuar drejtpërsëdrejti në produktivitetin në punë dhe konstruktivitetin në debat gjatë takimeve të zhvilluara nga komisionet. Mungesa e opositës ka ndikuar edhe në mbajtjen e mbledhjeve, pasi që në mungesë kuorumi 19 mbledhje kanë dështuar të mbahen gjatë periudhës raportuese. Një element tjetër që është vërejtur gjatë monitorimit të punës së komisioneve parlamentare gjatë sesionit pranveror ka qenë pasiviteti i deputetëve nga grupei parlamentar Lista Serbe (LS), të cilët nuk kanë shprehur interesim për t'u përfshirë në diskutimet e komisioneve.

Për dallim nga sesioni pranveror, një natyrë krejt tjetër e punës ka mbizotëruar gjatë sesionit vjeshtor. Komisionet, ndonëse për një periudhë më të shkurtër kohore (4 muaj sa ka zgjatur sesionin vjeshtor) kanë arritur të mbajnë një numër të konsiderueshëm të mbledhjeve dhe puna gjatë kësaj periudhe është intensifikuar dukshëm. Mirëpo, bojkoti ishte i pranishëm edhe gjatë këtij sesioni, pasi që grupei parlamentar i LS-së kishte bojkotuar punimet e Kuvendit në muajin tetor. Mungesa e deputetëve të LS-së ka ndikuar në punën e Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, shumica e anëtarëve të së cilit komision janë nga radhët e komuniteteve. Në dy raste në këtë komision votimi është bërë pa pasur kuorum të nevojshëm.

Komisionet parlamentare gjatë vitit 2016 kanë mbajtur gjithsej 362 mbledhje dhe 21 dëgjime publike. Krahasuar me vitin 2015 ku janë mbajtur 419 mbledhje dhe 38 dëgjime publike, në vitin 2016 komisionet parlamentare kanë mbajtur 57 mbledhje dhe 17 dëgjime publike më pak. Prej 21 dëgjimeve publike të mbajtura, në 14 prej tyre temë diskutimi ka qenë shqyrtimi i projektligjeve të caktuara ndërsa në 7 prej tyre është diskutuar për monitorim të zbatimit të ligjeve.

Rregullorja e Kuvendit obligon komisionet të mbajnë të paktën dy mbledhje në muaj, mirëpo kësaj dispozite nuk i janë përmbajtur katër nga komisionet e Kuvendit. Komisioni për Punë të Jashtme në sesionin pranveror për tre muaj radhazi nuk kishte mbajtur asnjë takim. Ngjashëm si ky komision kanë vepruar edhe Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media që në sesionin vjeshtor nuk ka thirrur mbledhje për më shumë se dy muaj. Një disbalancë ndërmjet performancën së komisioneve vërehet më së miri kur krahasohet Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media që ka mbajtur vetëm 14 takime gjatë gjithë vitit 2016, me Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Tregti dhe Industri që ka mbajtur gjithsej 47 takime.

Në këtë vit ashtu sikurse vitin paraprak, numri i përgjithshëm i projektligjeve të shqyrtuara ka qenë i vogël në krahasim me numrin e atyre që ishin paraparë për shqyrtim në Plan të Punës të seilit komision. Ndërsa arsyet pse komisionet nuk kanë përbushur planet për shqyrtim të projektligjeve ka qenë mos procedimi i tyre në Kuvend nga ana e Qeverisë, si sponsoruesi kryesor i agjendës legjislative.

Gjatë vitit 2016 edhe nismat ligjore nga Kuvendi kanë qenë të pakta, marrë parasysh faktin që ky është një nga rolet kryesore të këtij institucioni. Ndonëse në vitin 2015 ishin ndërmarrë tetë nisma ligjore ku vetëm dy prej tyre deri tani janë miratuar, në vitin 2016 Kuvendi ka iniciuar pesë ligje. Vetëm një prej tyre është shqyrtuar nga komisioni përkates dhe është miratuar në Kuvend, ai për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të UÇK-së, Viktimate Civile dhe Familjeve të tyre. Ndërsa katër të tjera kanë mbetur në procedurë të hartimit nga ekzekutivi, i cili ka paraparë t'i procedojë për Kuvend në programin legjislativ të vitit 2017.

Në kuadër të aktivitetave mbikëqyrëse, komisionet parlamentare gjatë vitit 2016 kanë ftuar për raportim 54 herë ministrat e kabinetit qeveritar. Në sesionin vjeshtor komisionet kanë qenë shumë më aktive në këtë aspekt, periudhë në të cilën janë bërë 72% e raportimit të ministrave. Kjo rritje e numrit të raportimeve të ministrave në komisione ka ardhur kryesisht si rezultat i mos procedimit të projektligjeve që komisionet kishin paraparë të shqyrtonin gjatë këtij sesioni, e të cilat Qeveria nuk i ka proceduar për shqyrtim në Kuvend.

Për dallim prej vitit 2015, ku aktivitetet për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve kanë qenë dukshëm më të mëdha, ku është bërë mbikëqyrja e zbatimit të 16 ligjeve, këtë vit komisionet parlamentare kanë shënuar regres në këtë aspekt. Nga 37 ligje të parapara për mbikëqyrje në bazë të planeve të punës të të gjitha komisioneve, vetëm gjashtë prej tyre kanë përfunduar në tërësi me miratim përfundimtar në Kuvend. Ndërsa në procedurë të mbikëqyrjes kanë mbetur edhe dhjetë ligje të tjera.

Tabela 1. Të dhënat statistikore të komisioneve parlamentare për vitin 2016

Emërtimi i komisionit	Mbledhje të mbajtura	Dëgjime Publike	Mungesat e deputetëve	Vonesat e deputetëve
Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport	44	5	130	41
Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korruptionit	39	2	110	12
Buxhet dhe Financa	32	0	107	19
Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri	42	5	183	41

Të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim	35	0	147	18
Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor	28	0	65	19
Mbikëqyrja e Financave Publike	18	2	52	19
Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje e Forcës së Sigurisë së Kosovës	20	2	33	17
Të Drejtat Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione	18	3	48	14
Integrime Evropiane	25	0	99	17
Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale	23	2	76	7
Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media	14	0	41	16
Stabilizim Asociim	9	0	35	8
Punë të Jashtme	19	0	48	10
Mbikëqyrja e Agjencionit Kosovar për Inteligjencë	9	0	33	/
Nën-Komisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit	2	0	/	/

2.1 Komisioni për Buxhet dhe Financa

Ky komisioni ka realizuar 32 mbledhje të rregullta dhe asnjë dëgjim publik. Në vitin e kaluar ky komision ka mbajtur 41 mbledhje, ndërsa këtë vit ka realizuar 9 mbledhje më pak. Asnjë dëgjim publik nuk është mbajtur në dy vitet e fundit nga ky komision.

Në cilësinë e komisionit raportues janë shqyrtuar 17 projektligje, nga të cilat 7 ishin projektligje për ratifikim të marrëveshjeve ndërkombëtare. Komisioni nuk qëndron mirë në aspektin e përm bushjes së planifikimeve pasi që kanë mbetur edhe 10 projektligje të pashqyrtuara të cilat komisioni në planin e punës i ka paraparë të shqyrtohen brenda vitit. Në cilësinë e komisionit të përhershëm ka shqyrtuar 35 projektligje të sjella nga komisionet raportues për vlerësim të implikimeve financiare. Për disa nga këto projektligje ka propozuar amendamente shtesë e që në disa raste ka ndikuar që ato projektligje të mos votohen në seancë pa pranimin e amendamenteve të këtij komisioni. Karakteristikë në punën e këtij komisioni për këtë vit ka qenë fakti se 6 projektligje janë shqyrtuar me procedura të përshtpjtor.

Asnjë ministër nuk ka qenë i ftuar në raportim në këtë komision, ndërsa rastet e vetme kur Ministri i Financave ka marrë pjesë në mbledhjet e këtij komisioni ishin rastet e sjelljes së ndonjë projektligji të ri për shqyrtim në komision. Gjithashtu komisioni nuk ka bërë mbikëqyrjen e ndonjë ligji edhe pse në plan të punës kishte paraparë dy të tillë. Megjithatë një proces të tillë, për monitorimin e zbatimit të një ligji e ka filluar por nuk ka arritur të përfundojë.

Një nga detyrat e komisionit është edhe shqyrtimi i raporteve vjetore dhe raporteve financiare të agjencive dhe institucioneve të pavarura. Komisioni ka shqyrtuar raportet për vitin 2015-të të 21 institucioneve dhe agjencive të pavarura. Disa prej këtyre raporteve janë shqyrtuar me kujdes, përderisa një pjesë tjetër e tyre vetëm janë votuar pa shqyrtim paraprak.

2.2 Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, gjatë vitit 2016, ka mbajtur gjithsej 35 mbledhje të rregullta dhe asnjë dëgjim publik. Në krahasim me vitin 2015, ky komision ka mbajtur 5 mbledhje më shumë. Efikasiteti i punës së komisionit ka mundur të jetë edhe më i lartë, mirëpo marrë parasysh bojkotet e njëpasnjëshme, sidomos nga Lista Serbe, puna e komisionit nuk ka qenë më e mira e mundshme. Madje, një pjesë e konsiderueshme e mbledhjeve, sidomos gjatë sesionit vjeshtor, është udhëhequr nga deputeti Agim Çeku, për shkak të mungesës së kryetares Jasmina Zivković, si rezultat i bojkotit të Listës Serbe.

Në cilësinë e komisionit të përhershëm, komisioni ka shqyrtuar gjithsej 46 projektligje nga aspekti i të drejtave dhe interesave të komuniteteve. Shumica e këtyre projektligjeve janë miratuar pa debat të mirëfilltë. Kurse, në Planin e Punës, ndonëse ishte paraparë që në cilësinë e komisionit funksional të shqyrtohet Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave dhe të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, kjo nuk ka ndodhur. Mirëpo, përkundër faktit që nuk ishte paraparë në Planin e Punës, komisioni ka iniciuar nismën legislative për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Festat Zyrtare, me kërkesë të deputetit Veton Berisha.

Sa i përket monitorimit të zbatimit të ligjeve, edhe pse ishte paraparë monitorimi i tre ligjeve, është përfunduar vetëm monitorimi i nenit 11 të Ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës, që si proces ka qenë i bartur nga viti 2015.

Kurse, në lidhje me mbikëqyrjen e ekzekutivit, ndonëse ishte paraparë raportimi i tetë ministrave të linjës, asnjë nga ministrat e paraparë nuk është ftuar në raportim në këtë komision. Për raportim është ftuar vetëm ministri Arsim Bajrami lidhur me regjistrimin e kandidatëve nga komunitetet jo-shumicë në universitetet publike. Ky raportim nuk ishte planifikuar në Plan të Punës.

2.3 Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korruptionit

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korruptionit ka realizuar 41 takime. Prej tyre, 25 mbledhje të rregullta dhe një dëgjim publik janë mbajtur gjatë sesionit pranveror ndërsa 14 mbledhje të rregullta dhe një dëgjim publik janë mbajtur në sesionin vjeshtor. Krahasuar me vitin e kaluar ku janë mbajtur 48 mbledhje të rregullta dhe një dëgjim publik, këtë vit dinamika e punës ka qenë më e ulët.

Plani i Punës nuk është përmbrushur plotësisht siç ka qenë i paraparë për vitin 2016. Si komisioni funksional, ishte planifikuar që t'i shqyrtoi 17 projektligje, por ka shqyrtuar vetëm katër prej tyre ndërsa dy të tjera kanë mbetur në procedurë, si rrjedhojë janë bartur për vitin 2017. Kurse edhe 11 projektligje të tjera që ishin paraparë në programin legjislativ të Qeverisë, nuk janë proceduar në komision për shqyrtim. Ndërkaq, komisioni ka shqyrtuar edhe Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me Mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Republikën e Kosovës, i cili nuk ka qenë pjesë e agjendës legislative të komisionit për vitin 2016. Si komision i përhershëm ka bërë shqyrtimin e 43 raporteve me amendamente të projektligjeve të ndryshme nga komisionet funksionale.

Komisioni kishte planifikuar mbikëqyrjen e zbatimit të katër ligjeve, ku në dy prej tyre përvëç caktimit të grupeve punuese, procedurat e mbikëqyrjes nuk kanë filluar gjatë periudhës raportuese. Ndërsa për dy ligjet të tjera, Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe atë për Këshillin Prokurorial të Kosovës, raporti i monitorimit ka përfunduar mirëpo ato nuk janë proceduar për Kuvend për miratim final. Në bazë të Planit të Punës është planifikuar shqyrtimi i raporteve vjetore për agjencitë e pavarura, mirëpo nuk është specifikuar sa agjenci apo cilat raporte do të shqyrtohen. Gjithsej janë shqyrtuar pesë raporte vjetore të punës, të Agjencisë Kundër Korrrupsionit, Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, Agjencisë Kosovare te Pronës, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Institutit Gjyqësor të Kosovës. Komisioni ka bërë mbikëqyrjen buxhetore të institucioneve që bien në fushëveprim të komisionit dhe në muajin qershor ka nxjerrë rekomandimet për ato institucione. Po ashtu komisioni ka shqyrtuar kërkessat buxhetore për vitin 2017 të institucioneve të linjës.

Ky komision gjatë vitit 2016 nuk ka qenë shumë efikas në përbushjen e rolit mbikëqyrës ndaj ekzekutivit. Vetëm Dhurata Hoxha, ministre e Drejtësisë ka raportuar një herë në këtë komision gjatë vitit 2016, ndërsa kanë munguar ftesat për raportim ndaj ministrave të tjerë të kabinetit qeveritar meqë është komision i përhershëm.

Edhe pse ka pasur mungesa nga anëtarët e komisionit, gjatë kohës sa kanë qenë prezent shumica prej tyre ishin mjaft aktiv nëpër diskutime dhe i janë përkushtuar shqyrtimit të projektligjeve, duke dhënë sugjerime apo duke komentuar nenet e caktuara.

2.4 Komisioni për Integrime Evropiane

Komisioni për Integrime Evropiane gjatë vitit 2016 ka zhvilluar 25 takime dhe asnjë dëgjim publik. Nga takimet e mbajtura, 14 janë mbajtur gjatë sesionit pranveror, kurse 11 gjatë atij vjeshtor. Në krahasim me vitin paraprak, komisioni ka mbajtur këtë vit 9 mbledhje më pak.

Komisioni në planin e tij të punës, nuk ka paraparë shqyrtimin e asnjë projektligji në cilësinë e komisionit funksional, kurse në cilësinë e komisionit të përhershëm ka ushtruar funksionin e tij ligjërës, duke bërë shqyrtimin e gjithsej 46 projektligjeve. Sa i përket monitorimit të ligjeve, komisioni ndonëse kishte paraparë monitorimin e tre ligjeve, ka monitoruar vetëm një, Ligjin për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së Fituar me Vepër Penale. Po ashtu, edhe sa i përket raportimeve të ministrave, Komisioni për Integrime Evropiane ka shënuar ngecje të shumta, pasi që ka pasur vetëm 5 raste të raportimit të ministrave, përkundër faktit që ishin paraparë 17 të tilla. Ministrat që kanë raportuar në komision janë: Skënder Hyseni (MPB), Hykmete Bajrami (MTI), Hajredin Kuçi (MD) dhe Blerand Stavileci dy herë (MZHE).

Përpos ministrave, komisioni ka zhvilluar dy takime informuese me Udhëheqësen e Zyrës së BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova, me të cilën ndër të tjera, temë kryesore e diskutimit ishte mos-liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës dhe standartet e dyfishta që BE-ja ka përdorur në rastin e Kosovës.

2.5 Komisioni për Punë të Jashtme

Komisioni për Punë të Jashtme gjatë vitit 2016 ka mbajtur 19 takime ndërsa nuk ka mbajtur asnjë dëgjim publik. Në krahasim me vitin e kaluar, numri i mbledhjeve për këtë vit është pothuajse i njëjtë, më saktësish një mbledhje më pak. Po ashtu, sikur vitin e kaluar, edhe këtë vit komisioni ka shkelur

Rregulloren e Punës së Kuvendit duke mos mbajtur të paktën dy mbledhje për çdo muaj, siç parashihet aty.

Për këtë vit, komisioni në planin e tij të punës ka paraparë shqyrtimin e vetëm një projektligji, atë për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës. Ky projektligji është shqyrtuar në komision por nuk është proceduar në seancë plenare për miratim, për shkak të disa dispozitave të diskutueshme. Përveç këtij projektligji, janë shqyrtuar edhe tri projektligje të tjera për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, prej të cilave edhe “Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi”, i cili është shoqëruar me shumë polemika dhe debate të ashpra mes partive në pushtet dhe atyre në opozitë. Madje, në mbledhjen e mbajtur më 9 gusht, ku ishte paraparë shqyrtimi i projektligjit në fjalë, pas diskutimeve të ashpra u hodh gaz lotsjellës. Përkundër situatës kaotike të shkaktuar nga hedhja e gazit lotsjellës, ky projektligj është miratuar nga komisioni, mirëpo jo edhe nga Kuvendi në seancë plenare.

Sa i përket monitorimit të zbatimit të ligjeve, komisioni ka iniciuar mbikëqyrjen e Ligjit për Protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës, mirëpo për shkak të mos-miratimit të raportit të monitorimit, vlerësohet se ky komision nuk ka përfunduar monitorimin e asnje ligji.

Në anën tjetër, komisioni krahasuar me vitin paraprak ka treguar performancë të lartë sa i përket ftesave për raportim të ministrave, sidomos në sesionin vjeshtor, kryesisht për shkak të mos-miratimit apo inicimit të ligjeve. Në plan të punës janë paraparë 7 raportime, mirëpo janë mbajtur vetëm 4 të tillë, të gjitha në sesionin vjeshtor. Ministrat që kanë raportuar në këtë komision janë: Enver Hoxhaj (Ministria e Punëve të Jashtme), Valon Murati (Ministria e Diasporës), Edita Tahiri (Ministria për Dialog) dhe Haki Demolli (Ministria e FSK-së), ndonëse ky raportim nuk ishte paraparë në planin e punës.

Në 3 nga gjithsej 19 mbledhjet e komisionit, është diskutuar për çështje që kanë të bëjnë me procesin e dialogut Kosovë-Serbi.

2.6 Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport ka mbajtur gjithsej 43 takime, prej tyre 38 mbledhje dhe pesë dëgjime publike. Nga numri i përgjithshëm i takimeve, 24 mbledhje dhe katër dëgjime publike janë mbajtur në sesionin pranveror, ndërsa 14 mbledhje dhe një dëgjim publik në sesionin vjeshtor. Nëse e krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit 2015, numri i mbledhjeve të mbajtura është më i madh këtë vit për tri mbledhje më shumë. Ndërsa sa i përket dëgjimeve publike, numri i tyre për këtë vit është më i vogël, me tri dëgjime më pak.

Sipas Planit të Punës janë paraparë që të shqyrtohen gjithsej nëntë projektligje, ku tre prej tyre janë bartur nga viti 2015. Nga të gjitha projektligjet e planifikuar për shqyrtim në vitin 2016, vetëm katër kanë arritur të procedohen për lexim të dytë në seancë, rrjedhimisht të bëhen ligje. Dy janë tërhequr nga ministritë përkatëse gjatë kohës sa kanë qenë në procedurë të shqyrtimit në komision kurse dy projektligje të tjera nuk janë proceduar fare nga Qeveria. E Projektligji për Inspektoratin e Arsimit në Kosovë ka mbetur në procedurë të shqyrtimit në komision dhe si i tillë është bartur në Programin Legjislativ për vitin 2017. Po ashtu, komisioni ka shqyrtuar edhe një projektligj për ratifikim të një marrëveshjeje ndërkombëtare, përkatësisht atë të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ambasadës së SHBA-ve në Prishtinë dhe MASHT-it për Programin “Fullbright” për Shkëmbim Akademik, i cili me Plan të Punës nuk ka qenë i planifikuar.

Krahas aktiviteteve lidhur me shqyrtimin e projektligjeve, ky komision ka qenë aktiv edhe në aktivitetet mbikëqyrëse ndaj ekzekutivit. Nga tri ministritë të cilat bien në fushëveprim të këtij komisioni, janë ftuar disa herë ministrat përkatës. Nga katër herë janë ftuar Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arsim Bajrami dhe Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Shala të cilat i janë përgjigjur pozitivisht ftesës. Kurse ministri i Diasporës, Valon Murati ka raportuar një herë në këtë komision.

Një prej aktivitetave kryesore që komisioni kishte planifikuar gjatë vitit 2016 është edhe mbikëqyrja e zbatimit të katër ligjeve që bien në kompetencë të tij. Mirëpo vetëm për një ligj kanë përfunduar procedurat e mbikëqyrjes, Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës. Ndërsa për tri ligje të tjera të planifikuara komisioni nuk ka ndërmarrë asnjë aktivitet. Sa i përket shqyrtimit të raporteve të organeve të pavarura, komisioni nuk ka shqyrtuar asnjë raport edhe pse në Planin e Punës për vitin 2016 janë paraparë të shqyrtohen dy të tilla. Sa i përket shqyrtimit të raporteve financiare të ministrive të linjës, një gjë e tillë nuk ka ndodhur në mënyrë periodike ashtu siç ishte planifikuar mirëpo janë diskutuar ndarjet buxhetore për vitin 2017 me të gjitha ministritë e linjës.

Një problematikë që e ka përcjell punën e këtij komisioni kanë qenë edhe problemet e paraqitura me disa prej projektligjeve me të cilat është marr ky komision. Projektligji për Arsimin e Lartë ishte tërhequr nga rendi i ditës nga ministri Bajrami në shqyrtimin e parë të tij, dhe më pastaj nuk është diskutuar asnjëherë për të. E njëjtë situatë ka ngjarë edhe me Projektligjin për Kinematografinë, një projektligj tjeter mjaft i rëndësishëm është tërhequr nga vetë Ministri Kujtim Shala, pasi që ka marrë kritika të shumta lidhur me përbajtjen e tij. Gjatë shqyrtimit të dytë në seancë për shkak të mospajtimeve të deputetëve rrëth amendamenteve, ministri kishte propozuar që ky projektligj të kthehej sërisht në grup punues. Edhe pas shumë diskajimeve me grupet e interesit dhe shqyrtimit nga ana e komisionit nuk ishte arritur të gjendet zgjidhje për mospajtimet për amendamentet përkatëse.

2.7 Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Është komisioni më aktiv me gjithsej 47 takime të realizuara brenda vitit, nga të cilat 42 mbledhje të rregullta dhe 5 dëgjime publike. Krahasuar me vitin e kaluar numri i mbledhjeve të komisionit këtë vit është për një më i vogël ndërsa numri i dëgjimeve publike është i njëjtë.

Gjithsej ka shqyrtuar 16 projektligje prej të cilave 12 janë miratuar në Kuvend. Ndërkohë 4 projektligje kanë mbetur në procedurë në komision një nga të cilët është nismë ligjore e komisionit. Numrin më të madh të mbledhjeve dhe projektligjeve të shqyrtuara i ka realizuar gjatë sesionit pranveror gjatë të cilit kanë mbajtur 28 takime dhe ka shqyrtuar 10 projektligje krahasuar me sesionin vjeshtor gjatë të cilit ka realizuar 19 takime dhe ka shqyrtuar 6 projektligje. Edhe pse ka shqyrtuar një numër të madh të projektligjeve komisioni nuk ka arritur të realizoj planifikimet e veta, pasi që në planin e punës ka paraparë shqyrtimin e 22 projektligjeve.

Sa i përket rolit të tij mbikëqyrës, komisioni ka bërë monitorimin e zbatimit të vetëm një ligji (Ligji për Miniera dhe Minerale) si dhe ka ftuar në raportim 3 ministrat e ministreve të linjës (Lutfi Zharku-Ministër i Infrastrukturës, Hykmete Bajrami- Ministre e Tregtisë dhe Industrisë dhe Blerand Stavileci-Ministër i Zhvillimit Ekonomik). Më tej, komisioni ka shqyrtuar edhe raportet e 5 agjencive të pavarura që bien në fushë veprimtarinë e komisionit si dhe ka zhvilluar vizita në Bordet e Ndërmarrjeve Publike, Agjencitë e Pavarura dhe nëpër biznese.

Gjatë këtij viti punën e komisionit e kanë përcjellë shqyrtimi i temave të rëndësishme dhe marrja e vendime të rëndësishme. Brenda këtij viti komisioni ka shqyrtuar dy ligje shumë të rëndësishme siç janë Ligji për Trepçën dhe Ligji për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës. Temë tjetër e rëndësise së lartë dhe shumë e debatuar ishte rasti me Propozim-vendimet e Qeverisë për konstatimit të interesit publik për lëshimin e licencës për dy kompani private për eksplotimin dhe gazifikim nëntokësor të thëngjillit në rajonin e Dukagjinit, vendime këto që në fund u refuzuan nga Kryesia e Kuvendit.

2.8 Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor ka mbajtur gjithsej 28 takime gjatë vitit 2016. Prej tyre 17 mbledhje janë realizuar në sesionin pranveror ndërsa në sesionin vjeshtor janë mbajtur 11 mbledhje, kurse nuk është mbajtur asnjë dëgjim publik nga ky komision gjatë gjithë periudhës raportuese. Krahasuar me vitin 2015, në vitin 2016 komisioni ka mbajtur dy mbledhje më shumë, duke përjashtuar dëgjimet publike që nuk janë realizuar asnjë, as në vitin paraprak.

Në bazë të Planit të Punës për vitin 2016, ky komision kishte planifikuar shqyrtimin e 18 projektligjeve, prej të cilave 17 projektligje kanë qenë në programin legjislativ të ekzekutivit, ndërsa një tjetër është iniciuar nga deputetët e Kuvendit të Kosovës që është bartur nga viti 2015. Nga numri i përgjithshëm i projektligjeve të parapara për vitin 2016 vetëm tre prej tyre janë proceduar në komision për shqyrtim. Dy prej këtyre projektligjeve kanë përfunduar, ndërsa një projektligj tjetër ka kaluar në shqyrtim të dytë në komision, por miratimi final në seancë është shtyrë për vitin 2017. Në kuadër të aktiviteteve legjislativë, ky komision gjatë vitit 2016 ka ndërmarrë dy nisma ligjore, atë për hartimin e Projektligjit për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz dhe Projektligjin për plotësim – ndryshimin e Ligjit për Shpronësimin e pronës së paluajtshme. Përveç procedimit të kërkesës në Qeveri për miratim, procedurat për këto dy nisma ligjore nuk kanë shkuar më tutje.

Për sa i përket rolit mbikëqyrës, është planifikuar mbikëqyrja e zbatimit të tri ligjeve prej të cilave vetëm njëri është realizuar, ai për Inspektoratin Bujqësor. Për raportim janë ftuar Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Memli Krasniqi ndërsa nga Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinorë, tash ish ministri Ferid Agani, një herë dhe ushtrues i detyrës së ministrit z. Ferat Shala dy herë të cilët i janë përgjigjur pozitivisht ftesës për raportim. Gjithashtu janë shqyrtuar edhe tri raporte vjetore të organeve të pavarura, ashtu siç ka qenë e paraparë në Planin e Punës.

2.9 Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Ky komision ka realizuar gjithsej 25 takime nga të cilat 23 mbledhje të rregullta dhe 2 dëgjime publike. Në vitin e kaluar ky komision ka realizuar 23 mbledhje të komisionit dhe 3 dëgjime publike, gjë që na len të kuptojmë se komisioni ka vazhduar me dinamikë të njëjtë të punës dy vitet e fundit.

Gjithsej ka shqyrtuar 5 projektligje nga të cilat 4 janë miratuar në Kuvend dhe kanë marrë statusin e ligjit ndërsa një projektligj ka mbetur në procedurë të shqyrtimit në komision. Gjithashtu ky komision ka ndërmarrë iniciativën për një nismë legislative por pas marrjes së një vendimit të tillë nuk ka punuar tutje në atë projektligj. Ndërkohë në planin e punës komisioni ka paraparë shqyrtimin e 9 projektligjeve nga të cilat 4 kanë mbetur pa u shqyrtuar.

Gjatë tërë vitit komisioni ka vazhduar me aktivitete në kuadër të procesit të monitorimit të zbatimit të Ligjit për Shëndetësi, të cilin aktivitet nuk ka arritur ta përfundoj. I planifikuar për këtë vit ka qenë monitorimi edhe i një ligji tjetër por komisioni nuk ka arritur as ta fillojë atë proces.

Në 5 raste komisioni ka ftuar për raportim ministrat. Ministri i Shëndetësisë, Imet Rahmani ka raportuar 3 herë para komisionit si dhe Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Arban Abrashi ka raportuar 2 herë në komision.

Gjatë vitit në mbledhjet e këtij komisioni janë shqyrtuar tema dhe probleme të ndryshme që kanë pasur të bëjnë me fushat që i mbulon ky komisionin. Vlen të ceket rasti kur komisioni ka dhënë kontributin e vet në bindjen e deputetëve për ta votuar Marrëveshjen ndërkombëtare për kredi për financimin e “Projektit të modernizimit të shërbimeve të kardiologjisë invazive”, marrëveshje kjo shumë e rëndësishme për sektorin e shëndetësisë. Rast tjetër që komisioni ka shqyrtuar dhe ka kontribuar ka qenë rasti kur komisioni pas kërkesës nga specialistët e mjekësisë për sistemimin dhe buxhetimin e pagave të tyre, ka arritur që kërkesa e specialistëve të zënë vend në Ligjin për plotësim ndryshimin e Ligjit për Buxhet të vitit 2016.

Në mbledhjet e komisionit janë shqyrtuar edhe tema të tjera të cilat kanë ardhur në formë të ankesave të tillë si: ndarja e specializimeve të profesionistëve shëndetësorë, titujt akademik për punëtorët shëndetësor, shqetësimi i shoqatës së diabetologëve lidhur me cilësinë e insulinës në institucionet shëndetësore, etj.

2.10 Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FKS-së gjatë vitit 2016 ka zhvilluar gjithsej 22 takime prej tyre 20 mbledhje të rregullta dhe dy dëgjime publike. 11 takime janë realizuar në sesionin pranveror, nga to nëntë kanë qenë mbledhje të rregullta dhe dy dëgjime publike, ndërsa në sesionin vjeshtor komisioni ka mbajtur vetëm 11 mbledhje të rregullta dhe asnje dëgjim publik. Nga krahësimi me vitin e kaluar, del se këtë vit komisioni ka mbajtur tri mbledhje më pak.

Ndonëse numri i mbledhjeve të mbajtura nga ky komision nuk ka qenë i vogël, një prej sfidave që e ka shoqëruar këtë komision gjatë vitit 2016 ka qenë mos procedimi i projektligjeve nga Qeveria, të cilat kanë qenë të parapara në programin legjislativ të ekzekutivit, rrjedhimisht edhe në planin e aktiviteteve të komisionit. Marrë parasysh faktin që shqyrtimi dhe amandamentimi i projektligjeve është një nga detyrat kryesore të komisioneve, ky komision e ka pasur të pamundur ta ushtroj këtë funksion në mungesë të projektligjeve. Me Plan të Punës, komisioni kishte planifikuar që brenda vitit 2016 të shqyrtoi 10 projektligje prej të cilave vetëm një është shqyrtuar në parim, ai për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve të vogla dhe të lehta, municionit dhe mjeteve eksplozive. Ndërsa projektligjet e tjera nuk janë sjellë fare në komision nga sponzorizuesi kryesor i tyre, Qeveria.

Përkundër kësaj, komisioni ka qenë aktiv në detyrat e tjera të përcaktuara me Rregulloren e Punës. Sa i përket mbikëqyrjes së ekzekutivit, gjegjësisht ministritë e linjës, komisioni i është përmbajtur Planit të Punës. Në raportim janë thirrur ministri i FSK-së, Haki Demolli dy herë dhe ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Skender Hyseni një herë, e të cilit i janë përgjigjur pozitivisht ftesës. Edhe pse me Plan të Punës nuk është paraparë mbikëqyrja e zbatimit të ndonjë ligji, ky komision gjatë sesionit vjeshtor ka shtuar si aktivitet edhe mbikëqyrjen e Ligjit për Inspektoriatin e Policisë së Kosovës. Mirëpo ky aktivitet ka mbetur në procedurë për vitin 2017 ndonëse është formuar grupi punues. Po ashtu, janë shqyrtuar edhe tre nga katër raporte vjetore të institacioneve që bien në fushëveprimin e këtij

komisioni të planifikuara në Plan të Punës. Përveç kësaj komisioni ka shqyrtuar edhe ndarjet buxhetore për vitin 2017 së bashku me ministritë e linjës.

Për dallim nga shumica e komisioneve që mbledhjet i kanë filluar gjithmonë me vonesë, ky komision është ndër të paktë që e kanë respektuar orarin e caktuar për fillimin e mbledhjeve.

2.11 Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media ka mbajtur gjithsej 14 mbledhje të rregullta, kurse asnjë dëgjim publik. Ky komision është ndër komisionet me më së paku mbledhje të mbajtura, sidomos gjatë sesionit vjeshtor, kur janë mbajtur vetëm katër sosh. Në krahasim me vitin 2015, komisioni ka mbajtur 16 mbledhje më pak, që i bie më se përgjysmë më pak se gjatë vitit paraprak.

Komisioni ka paraparë shqyrtimin e 11 projektligjeve, mirëpo janë miratuar vetëm dy prej tyre, kurse Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për RTK-në ka mbetur ende në procedurë të shqyrtimit në komision. Shumë projektligje me rëndësi, si ai për kryeqytetin, për qeverinë apo për pagat nuk janë sjellë fare në komision.

Ky komision qëndron dobët edhe sa i përket mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve, pasi që përkundër faktit se ishte paraparë mbikëqyrja e zbatimit të pesë ligjeve, asnjë prej tyre nuk është monitoruar.

Sipas Planit të Punës, komisioni kishte paraparë raportimin e tre ministrave të linjës, kurse prej tyre ka rapportuar vetëm ministri Mahir Yağcılar. Në raportim është ftuar edhe ministrja Edita Tahiri rrëth çështjes së kufijve administrativ dhe diskutimin e kësaj teme në dialogun mes Kosovës dhe Serbisë.

Nga pesë raporte të organeve të pavarura sa janë paraparë për shqyrtim këtë vit, katër prej tyre janë shqyrtuar dhe janë proceduar për miratim në Kuvend.

2.12 Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike (KMFP)

Ky komision ka realizuar 20 takime nga të cilat 18 mbledhje të rregullta dhe dy dëgjime publike. Në vitin 2015 ky komision ka mbajtur 24 takime apo 4 më shumë se këtë vit.

Në planin e punës për vitin 2016, komisioni ka paraparë shqyrtimin e vetëm një projektligji në fillim të vittit pasi që i njëjti është bartur nga viti paraprak. Pas shqyrtimit nga komisioni ky projektligj është miratuar në Kuvend. Ndërkohë komisioni ka shqyrtuar edhe një projektligj që nuk e kishte paraparë në planin e punës, i njëjti ka mbetur në procedurë të shqyrtimit në komision.

Fushë veprimtaria e KMFP ka të bëjë kryesish me shqyrtimin e Raporteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) për Pasqyrat Vjetore Financiare të organizatave buxhetore. Gjatë sesionit pranveror përderisa komisioni ishte në pritje të raporteve të auditimit ka vazhduar me shqyrtimin e raporteve kthyese të disa organizatave buxhetore për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga KMFP me rastin e shqyrtimit të raporteve të auditimit të PVF-ve të përgatitura nga ZKA në vitin e kaluar.

Pas dorëzimit të raporteve të auditimit nga ZAP (93 raporte, prej tyre 37 të komunave), komisioni ka filluar me shqyrtimin e këtyre raporteve me që rast ka ftuar në komision përfaqësues nga ZKA dhe drejtuesit e organizatave buxhetore përkatëse për të arsyetuar të gjeturat në raport. Në total në

komision janë shqyrtuar 12 raporte të tilla. Gjatë këtij procesi komisioni ka hasur në probleme pasi që të ftuarit nga komisioni nuk i janë përgjigjur thirrjes së komisionit.

2.13 Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencionit Kosovar për Inteligjencë

Ky komision ka mbajtur gjithsej nëntë mbledhje të rregullta. Shtatë prej tyre janë mbajtur në sesionin pranveror ndërsa vetëm dy në sesionin vjeshtor. Numri i mbledhjeve të mbajtura nga ky komision për këtë vit është më i vogël në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ku janë mbajtur gjithsej 12 mbledhje.

Të gjitha takimet e këtij komisioni janë mbajtur me dyer të mbyllura dhe procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura nuk janë publike, përvèç mbledhjes së fundit ku është diskutuar për Planin e Punës të këtij komisioni, plan ky i cili nuk është publik. Për këtë arsy nuk ka qenë i mundur monitorimi i performancës së deputetëve që janë pjesë e këtij komisioni e as e komisionit në tërsësi. Megjithatë pjesëmarrja e deputetëve është evidentuar pa filluar mbledhja dhe janë verifikuar nga të dhënat e ueb-faqes së Kuvendit të Kosovës.

Në bazë të pikave të rendit të ditës për secilën mbledhje të mbajtur, të cilat ka qenë të publikuar në ueb-faqen e Kuvendit kuptojmë që ky komision nuk ka shqyrtuar asnë projektligji. Komisioni ka filluar procedurat për të mbikëqyrë zbatimin e Ligjit për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë. Nuk është ftuar për raportim asnë ministër, mirëpo kanë qenë të ftuar disa herë drejtori i AKI-së Agron Selimaj dhe Inspektori i Përgjithshëm, Shkelzen Sopjani.

2.14 Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Petitione

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Petitione ka zhvilluar gjithsej 18 mbledhje të rregullta dhe 3 dëgjime publike. Në krahasim me vitin 2015, këtë vit janë mbajtur 10 mbledhje më pak, mirëpo qëndron dukshëm më mirë sa i përket dëgjimeve publike, duke qenë se gjatë vitit 2015 nuk është mbajtur asnë i tillë.

Sipas Planit të Punës, është paraparë shqyrtimi i tre projektligjeve. Është miratuar në parim vetëm njëri prej tyre, Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Lirinë Fetare në Kosovë, kurse në procedurë të shqyrtimit në komision ka mbetur Projektligji për Mbrojtjen e Fëmijës, që është bartur për vitin 2017.

Komisioni ka mbikëqyrur zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, siç edhe ishte paraparë. Kurse, ndonëse komisioni nuk kishte paraparë që të ftohet ndonjë ministër për raportim, pas kërkesës së banorëve të fshatit Vranishtë të Komunës së Dragashit, ka rapportuar ushtruesi i detyrës së ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ferat Shala, rrëth ndërtimit të një hidrocentrali në atë fshat.

Komisioni ka shqyrtuar edhe disa petitione, ndër të cilët edhe petitionin e rrëth 24 mijë qytetarëve për rastin “Dehari”.

2.15 Komisioni Parlamentar për Stabilizim Asociim

Me të hyrë në fuqi Marrëveshja për Stabilizim - Asociim ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian, Kuvendi i Kosovës si një nga akterët kryesor institucional në zbatimin e kësaj marrëveshje dhe në

përputhje me PKZMSA-në (Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes për Stabilizim – Asociim) ka themeluar Komisionin Parlamentar për Stabilizim Asociim që është organi i parë i përbashkët me BE-në.

Mënyra e funksionimit të këtij komisioni është e rregulluar me Rregulloren e Punës së Komisionit të hartuar dhe miratuar nga vet komisioni si dhe në përputhje me nenin 132 të MSA-së. Në takimet zyrtare, anëtarët nga të dyja komisionet (KPSA dhe komisionit të BE-së) kanë për detyrë të informojnë njëri – tjetrin për priorititet respektive dhe për nivelin e implementimit të marrëveshjeve të arritura. Në bazë të kësaj, ata mund të nxjerrin rekomandime për të dyja palët e përfshira në marrëveshje. Po ashtu, monitorojnë progresin e arritur të Kosovës në këtë rast, për anëtarësimin në BE. Numri i takimeve nuk është i përcaktuar, kjo mund të vendoset në koordinim mes të dyja palëve mirëpo komisioni është i obliguar të takohet të paktën një herë në vit.

Në përbërje të këtij komisioni parlamentar të themeluar nga Kuvendi i Kosovës janë të përfaqësuar deputetët të të gjitha subjekteve politike që pasqyrojnë përbërjen e Kuvendit. Ky komision numëron 15 anëtarë gjithsej, aq sa ka edhe komisioni nga BE-ja.

Që nga muaji prill i këtij viti, kur edhe është themeluar ky komision, e deri në fund të vitit 2016 janë mbajtur gjithsej nëntë takime. Në sesionin pranveror ky komisioni ka mbajtur pesë takime, ku një nga to kanë qenë takim i përbashkët me Komisionin Parlamentar për MSA-në nga BE-ja. Katër takimet e para kanë pasur karakter informues e përgatitor për mbledhjen e përbashkët me përfaqësuesit e komisionit parlamentar nga BE-ja.

Ndërkaq në sesionin vjeshtor, ky komision ka mbajtur katër takime, prej të cilave tri ishin takime përgatitore, ndërsa një ishte takim i përbashkët me komisionin për MSA-në nga BE-ja, i mbajtur në Bruksel. Në këto takime nuk ka pasur pjesëmarrje të rregullt të të gjithë deputetëve, anëtarë të këtij komisioni.

Mirëpo në takimet zyrtare, të pranishëm kanë qenë të gjithë anëtarët e këtij komisioni, të të gjitha grupeve parlamentare të Kuvendit të Kosovës.

Në takimet e mbajtura me datë 16 dhe 17 maj 2016 në Kosovë dhe me 23 dhe 24 nëntor në Bruksel, komisioni parlamentar për Stabilizim Asociim nga Kuvendi i Kosovës dhe ai Evropian kanë diskutuar për gjashtë tema¹. Pas diskutimeve nga të dyja takimet janë dhënë dhe miratuar rekomandimet mbi çështjet e diskutuara.


3. MBARËVAJTJA E SEANCAVE PARLAMENTARE

Numri i seancave parlamentare gjatë vitit 2016 ka shënuar rënie në krahasim me vitin paraprak, ndonëse Kuvendi i është kthyer normalitetit pas ndërhyrjeve dhe pengesave në mbajtjen e seancave nga opozita në vitin 2015. Megjithatë gjatë këtij viti intensiteti i punës së Kuvendit ka pasur luhatje të kohëpaskohshme, gjë e cila ka ardhur kryesisht si shkak i bojkotit të partive opozitare në fillim vit, duke vazhduar me bojkot nga Lista Serbe nga fundi i vitit. Disa herë seancat kanë dështuar të mbahen në

¹ Temat e trajtuar nga komisioni janë: Gjendja e marrëdhënieve BE-Kosovë; Dialogu politik dhe funksionimi i institucioneve demokratike; Marrëdhënet me fqinjët dhe bashkëpunimi rajonal, duke përfshirë dialogun e lehtësuar mes Kosovës dhe Serbisë nga BE-ja; Zhvillimi ekonomik në lidhje me sundimin e ligjit, përfshirë luftën kundër korruptionit; Fuqizimi i Rinisë dhe Antiradikalizm; Dialogun Social- Shëndetësia dhe Arsimi; Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut veçanërisht atyre me nevoja të veçanta dhe Pluralizimi i Mediave.

mungesë kuorumi, ndonëse partnerët e koalicionit qeverisës kanë mbi dy të tretat e deputetëve në Kuvend. Mungesa e kuorumit ka vazhduar si problematikë edhe në sesionin vjeshtor, pothuajse në të gjitha seancat e mbajtura, aq sa ishte e pamundur që të hidheshin në votim të gjitha pikat e rendit të ditës në një seancë të caktuar.

Grafikoni 1. Krahasimi i seancave për vitin 2016 me 2017



Seancat Plenare – Në vitin 2016 Kuvendi i Kosovës ka mbajtur gjithsej 25 seanca plenare, shifër kjo që tregon rënien të intensitetit të punës në këtë aspekt krahasuar me vitin 2015, ku janë mbajtur gjashtë seanca më shumë. Përveç numrit më të vogël të seancave të mbajtura këtë vit, në shumicën e rasteve mungesa e kuorumit ka pamundësuar votimin qoftë të ligjeve, raporteve apo zgjedhjen e anëtarëve të bordeve të institucioneve të caktuara në ditën që janë planifikuar. Në raste të tilla, Kuvendi e kishte bërë praktikë që njëherë t'i diskutoi pikat e caktuara të rendit të ditës, përderisa votimet shtysheshin për ditën tjeter atëherë kur arrihej kuromi i nevojshëm për votim.

Seancat e jashtëzakonshme – Seancat e jashtëzakonshme në vitin 2016 kanë qenë më të shpeshta e veçanërisht në sesionin vjeshtor, kryesisht për shkak të shqyrimit të ligjeve të caktuara me procedurë të përshpejtuar. Për dallim nga viti 2015 ku janë mbajtur pesë seanca të jashtëzakonshme, këtë vit numri i këtyre seancave ka qenë më i madh për dy sosh. Në seancën e parë të jashtëzakonshme është zgjedhur Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi. Tri seanca të tjera të këtij lloji janë mbajtur për shqyrtim të tri ligjeve, atij për plotësim – ndryshim të Ligjit për vazhdimin e mandatit të misionit të BE-së për sundimin e ligjit EULEX, Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për plotësim – ndryshimin e Ligjit për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ndërsa në tri seanca të tjera janë mbajtur debate parlamentare të cilat janë thirrur me kërkesë të grupeve parlamentare.

Seancat solemne – Kuvendi i Kosovës gjatë vitit 2016 ka mbajtur katër seanca solemne, që në krahësim me vitin 2015 i bie të ketë mbajtur dy seanca më shumë. E para është mbajtur me rastin e betimit të presidentit, ndërsa në tri rastet e tjera kur janë mbajtur seanca solemne kanë qenë adresime, si ai Federica Mogherini, përfaqësuese e lartë e BE-së për Punë të Jashtme dhe Politika të Sigurisë, i Boris Johnson, Deputet i Parlamentit, Ministër i Punëve të Jashtme dhe të Komonuellhit të Mbretërisë së Bashkuar. Ndërkaq, seanca e fundit solemne për vitin 2016 ka pasur për temë adresimin e presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, para deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Pjesëmarrja e deputetëve në seanca

Viti 2016 është karakterizuar me numër më të vogël të seancave të mbajtura, njëkohësisht me një pjesëmarrje më të ulët të deputetëve në seanca. Krahasuar me vitin 2015 ku ishin regjistruar 865 mungesa gjithsej, në vitin 2016 numrin i përgjithshëm i mungesave të të gjithë deputetëve ishte 1,042. Mesatarisht secili nga 120 deputetët (duke i përfshirë këtu edhe ata që janë zëvendësuar) kanë munguar rrëth tetë herë gjatë gjithë vitit raportues.

Në bazë të grupeve parlamentare, grupi parlamentar i LVV-së prin për nga numri i mungesave më gjithsej 250 mungesa, të pasuar nga Lista Serbe me 178 mungesa, AAK me 160 mungesa, NPK me 133 mungesa, PDK me 123 mungesa, LDK me 117 mungesa, deputetët pa grup parlamentar me 60 mungesa dhe grupi parlamentar 6+ me 21 mungesa.

Sa i përket deputetëve me më së shumti mungesa prin Fatmir Limaj (8) mungesa, i pasuar nga Valdete Bajrami (24), Jelena Bontic (24), Daut Haradinaj (22), Time Kadrijaj (21), Bali Muharremaj (21), Zafir Berisha (21), Haxhi Shala (21), Ilir Deda (21), Enver Hoti (21), Rrustem Berisha (20), Pal Lekaj (20).


Vetëm gjashtë deputetët nga 120 sa janë gjithsej kanë marrë pjesë në të gjitha seancat e mbajtur gjatë vitit 2016. Prej tyre, tre deputetë janë nga grupi parlamentar i PDK-së (Luljeta Veselaj – Gutaj, Mexhida Mjaku – Topalli dhe Zenun Pajaziti), ndërsa tre të tjerë janë nga grupi parlamentar i LDK-së (Ali Sadriu, Milazim Haliti dhe Sabri Hamiti).

Një karakteristikë që e ka përcjellë Kuvendin këtë vit, por edhe gjithë Legjislaturën e V-të, janë lëvizjet e shumta të deputetëve qoftë brenda grupeve parlamentare apo duke dhënë dorëheqje nga posti i deputetit. Ilir Deda nga LVV ka kaluar si deputetë pa grup parlamentar, ndërsa nga fundi i vitit deputeti Ramiz Kelmendi ka dhënë dorëheqje për të iu bashkuar kabinetit qeveritar si zëvendëskryeministër nga radhët e LDK-së. Deputetja Donika Kadaj – Bujupi ka kaluar nga grupi parlamentar i AAK-së në atë të LVV-së. Në anën tjetër, shtatë deputetë për arsyte të ndryshme kanë dorëzuar mandatet e deputetit. Nga PDK mandatet i dorëzuan tre deputetë: Azem Syla, Enver Hoxhaj dhe Fadil Demaku, nga LDK dy deputete: Teuta Sahatqija dhe Alma Lama, si dhe Besnik Bislimi nga LVV dhe Ramush Haradinaj nga AAK.

4. PËRMBUSHJA E AGJENDËS LEGJISLATIVE

Kuvendi në vitin 2016 ka miratuar 52 ligje apo 37% të projektligjeve të planifikuara për miratim. Në procedurë të shqyrtimit në komisione parlamentare kanë mbetur edhe 19 projektligje (13%) ndërsa 71 projektligje (50%) nuk janë shqyrtuar fare në Kuvend.

Grafikoni 2. Përmbushja e agjendës legislative për vitin 2016



Dinamikë dukshëm më e lartë në miratimin e ligjeve është vërejtur në sesionin pranveror edhe pse në pjesën më të madhe të këtij sesioni partitë opozitare kanë bojkotuar punimet e Kuvendit. Në sesionin pranveror janë miratuar 35 ligje ndërsa në sesionin vjeshtor 17 ligje. Gjatë dy sesioneve e sidomos në sesionin vjeshtor projektligjet janë diskutuar në një ditë ndërsa janë votuar në ditën tjetër, kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së kuorumit në seanca plenare.

Karakteristikë për vitin 2016 ishte se Kuvendi ka zhvilluar punimet pa miratuar një plan të punës ashtu siç parashihet me Rregulloren e punës së Kuvendit. Programi Legjislativ i Kuvendit për vitin 2016 ka përfshirë projektligjet e parapara në Programin Legjislativ të Qeverisë, ato të parapara në Planet e punës së komisioneve parlamentare dhe projektligjet e bartura nga viti paraprak. Gjithsej programi legjislativ i Kuvendit për 2016 ka përfshirë 142 projektligje. Sa i përket projektligjeve të cilat kanë mbetur në procedurë nëpër komisione vitin e kaluar, shumica e tyre (17) janë miratuar këtë vit ndërsa disa prej tyre (6) vazhdojnë të mbeten në procedurë nëpër komisione.

Edhe këtë vit është përsëritur dukuria e miratimit të ligjeve me procedurë të përshpejtuar, gjë që ka ndodhur në 9 raste. Madje edhe ligji më i rëndësishëm për shtetin, Ligji për Buxhetin për vitin 2017, është miratuar me procedurë të përshpejtuar. Vlen të ceket rasti i Ligjit për Buxhetin për vitin 2017, i cili është ligji më i rëndësishëm për shtetin dhe i cili ishte njëri ndër ligjet të cilat janë miratuar me procedurë të përshpejtuar.


Përmbushja e vetëm 35 % të programit legjislativ nga ana e Kuvendit dëshmon për performancë jo të mirë sa i përket miratimit të ligjeve. Përgjegjësia për përmbushjen e ulët të programit legjislativ bie edhe mbi Qeverisë si sponsorizuese kryesore e projektligjeve, pasi që nuk i ka sjellë në Kuvend projektligjet e planifikuara në agjendën legislative. Por kjo nuk e përashton përgjegjësinë e Kuvendit i cili nuk ushton presion mbi Qeverinë për sjelljen e projektligjeve të planifikuara si dhe është pasiv

në ndërmarrjen e nismave ligjore. Mosrealizimi i planifikimeve po ndodhë në vazhdimësi për shkak të planifikimeve ambicioze nga ana e Kuvendit.


Ligjet e miratuara

Gjatë vitit 2016 Kuvendi ka miratuar 52 ligje. Si në vitet tjera ashtu edhe këtë vit shumica dërmuese e ligjeve të miratuara (49) kanë qenë të sponsorizuara nga Qeveria ndërsa vetëm për dy prej tyre sponsorizues ka qenë Kuvendi dhe një ka qenë iniciativë qytetare. Këto tri ligje të cilat nuk ishin të sponsorizuara nga Qeveria ishin të bartura nga viti i kaluar. Edhe këtë vit një numër i konsiderueshëm i ligjeve janë sjellë nga Qeveria për plotësim-ndryshim. Nga tërësia e ligjeve të miratuara tetë nga to ishin ligje të iniciuara nga Qeveria për plotësim-ndryshim ndërsa 44 ligje të reja. Po ashtu, këtë vit Kuvendi ka miratuar 12 marrëveshje ndërkontaktuale nga të cilat 9 kanë qenë marrëveshje ndërkontaktuale me karakter financiar.

Grafikoni 3. Ligjet e miratuara sipas sponzoruesit




Grafikoni 4. Krahasimin ndërmjet ligjeve të reja dhe atyre të sjellura për plotësim/ndryshim



Ligjet e miratuara në Kuvend gjatë vitit 2016 sipas sektorëve që i rregullojnë përfshijnë 16 ligje nga fusha e financave; 5 për drejtësi; nga 3 ligje për shëndetësi dhe energetikë; nga 2 për ekonomi, administratë, anti-korrupsion, ambient, tregti, metalurgji, sport, sociale dhe komunikacion si dhe nga 1 ligj për kulturë, punë të jashtme, drejta të njeriut, arsim dhe siguri.

Grafikoni 5. Ligjet e miratuara sipas sektorëve



Projektligjet në procedurë

Në procedurë të shqyrtimit nëpër komisione kanë mbetur gjithsej 19 projektligje. Nga ky total, 8 janë projektligje të sjella nga Qeveria për plotësim ndryshim ndërsa 11 nga ta janë projektligje të reja.

Projektligjet që kanë mbetur në procedurë nëpër komisione klasifikuar sipas sektorëve që i rregullojnë janë: 4 nga sektori i drejtësisë, 3 për të drejtat e njeriut, 2 për tregti dhe nga 1 projektligj për shëndetësi, ambient, financa, ekonomi, administratë, arsim, media, punë të jashtme, sociale dhe infrastrukturë.

Projektligjet në pritje

Pjesa më e madhe e projektligjeve të parapara në programin legjislativ të Kuvendit nuk janë shqyrtuar fare këtë vit. Janë gjithsej 71 projektligje të cilat edhe pse janë paraparë për shqyrtim këtë vit nuk janë shqyrtuar fare. Nga tërësia e projektligjeve të planifikuara për miratim këtë vit projektligjet që nuk janë shqyrtuar në Kuvend paraqesin 50% të tyre.

Në listën e projektligjeve të pashqyrtuara bëjnë pjesë edhe 11 projektligje të cilat, ditët e fundit të vitit 2016 janë proceduar në Kuvend. Nga këto projektligje 7 ishin proceduar nga Qeveria kurse 4 të tjera ishin nisma legislative të Kuvendit. Për asnjërin prej këtyre projektligjeve nuk kanë filluar procedurat e shqyrtimit nëpër komisione andaj konsiderohen si projektligje të pashqyrtuara në vitin 2016.

5. MBIKËQYRJA PARLAMENTARE

5.1 Pyetjet parlamentare


Pyetjet parlamentare janë ndër mekanizmat kryesorë, nëpërmjet të cilave ushtrohet roli mbikëqyrës i Kuvendit ndaj punës së ekzekutivit. Nëpërmjet këtyre pyetjeve, deputetët kanë mundësi që të kërkojnë llogari nga kryeministri apo ministrat rreth punës dhe efikasitetit të tyre, apo rreth ndonjë problemi të caktuar. Sipas Rregullores së Punës së Kuvendit, rendi i ditës në çdo mbledhje duhet të parasheh 60 minuta për pyetje parlamentare, ku secili deputet ka të drejtë të parashtroj më së shumti 2 pyetje,² të cilat zgjasin jo më shumë se dy minuta. Më tutje, deputeti ka të drejtë të parashtrojë edhe një pyetje ndihmëse e cila nuk duhet të zgjasë më shumë se një minutë.³ Në rast se pyetja nuk merr përgjigje brenda dy seancave pasuese, atëherë pyetja publikohet në Revistën e Kuvendit dhe në faqen zyrtare elektronike të Kuvendit.

Marrë parasysh numrin e paraparë të pyetjeve parlamentare sipas Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës për secilin deputet, atëherë del se deputetët e Kuvendit të Kosovës e ushtrojnë minimalisht rolin e tyre mbikëqyrës ndaj ekzekutivit.

Gjatë vitit 2016, deputetët kanë parashtruar vetëm 173 pyetje parlamentare, për dallim nga viti 2015 kur ishin parashtruar gjithsej 216 pyetje parlamentare. Nga numri i përgjithshëm i pyetjeve të parashtruara(173) këtë vit, përgjigje kanë marrë vetëm 76 prej tyre, që përkthyer në përqindje i bie vetëm 44%. Kjo përqindje është shumë më e ulët sesa në vitin 2015, kur përgjigje kishin marrë 68% e pyetjeve parlamentare.

Performanca e dobët e Kuvendit në ushtrimin e rolit mbikëqyrës, vjen kryesisht si rezultat i bojkoteve dhe mungesës së deputetëve nëpër shumicën e seancave, ngjarje të cilat e kanë shoqëruar Kuvendin e Kosovës pothuajse gjatë gjithë vitit.

Grafikoni 6. Paraqitura e pyetjeve parlamentare të përgjigjura dhe të refuzuara



Ngjashëm sikur gjatë vitit 2015, edhe këtë vit, pyetjet parlamentare drejtuar kabinetit qeveritar kanë ardhur kryesisht nga opozita, më konkretisht nga LVV-ja, e cila ka parashtruar më shumë se gjysmën e numrit të përgjithshëm të pyetjeve parlamentare (89), pasuar nga grupi parlamentar i PDK-së (49),

² Rregullore e Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 45, pika 1.

³ Rregullore e Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 45, pika 2.


AAK-së (12), NISMA-s (11), LDK-së (8) dhe nga deputetët pa grup parlamentar (2). Kurse, nga subjektet politike nga komunitetet jo-shumicë, janë parashtruar vetëm 2 pyetje parlamentare, njëra nga grupei parlamentar i Listës Serbe dhe tjetra nga grupei parlamentar 6+.

Grupi parlamentar i PDK-së prin sa i përket numrit të përgjigjeve të marra nga ekzekutivi, me gjithsej 31 përgjigje të marra, ndjekur nga grupei parlamentar i LVV-së me 30, LDK-së me 5, AAK-së dhe NISMA-s me nga 4, Listës Serbe dhe grupit parlamentar 6+ me nga 1, dhe deputetët pa grup parlamentar (Margarita Kadriu-Ukelli) që nuk ka marrë asnje përgjigje.

Megjithatë, numri i përgjigjeve të dhëna ndaj pyetjeve parlamentare mbeten relativisht i ulët. Nga gjithsej 173 pyetje parlamentare, përgjigje nuk është dhënë në 97 prej tyre. Grupet parlamentar ndaj të cilëve janë dhënë më së paku përgjigje janë: LVV (59 pyetje pa përgjigje), PDK (18 pyetje pa përgjigje), AAK (8 pyetje pa përgjigje), NPK (7 pyetje pa përgjigje), LDK (3 pyetje pa përgjigje) dhe deputetët pa grup parlamentar (2 pyetje pa përgjigje).

Sa i përket sektorëve, edhe këtë vit, Shëndetësia mbeten sektori ku janë parashtruar më së shumti pyetje parlamentare (24). Pas Shëndetësisë, sektorët ku janë parashtruar pyetje janë: Punët e brendshme (22), çështjet sociale (20), arsimi (19), dialogu (14), infrastruktura (10), të drejtat e njeriut (9), drejtësia (7), financat (6), siguria (5), bujqësia (4), ekonomia (4), metalurgjia (4), tregtia (4), administrata (3), aviacioni (3), sporti (3), energetika (2), kundër-korrupsioni (2), kultura (2), punët e jashtme (2), ambienti (1), komunikacioni (1), migrimi/kthimi (1) dhe qeverisja lokale (1).

Grafikoni 7. Pyetjet parlamentare sipas sektorëve



Cak i adresimit të pyetjeve parlamentare kanë qenë ministrat nga radhët e LDK-së, duke përfshirë kryeministrin, ndaj të cilëve janë parashtruar shumica dërrmuese e pyetjeve (74%), apo më konkrektisht 128 të tillë. Më së shumti pyetje i janë parashtruar kryeministrit Isa Mustafa (34) dhe ministrave Imet Rrahmani(23), Arsim Bajrami (22), Skënder Hyseni (21), Arban Abrashi (20) dhe Lutfi Zharku (12).


Nga gjithsej 21 ministra sa ka Qeveria e Kosovës, pyetje parlamentare janë parashtruar për 17 prej tyre, përfshirë edhe kryeministrin Mustafa.

5.1.1 Përgjigjet e kryeministrit

Kryeministri Isa Mustafa gjatë vitit 2016 ka qenë subjekti i preferuar i deputetëve për parashtrim të pyetjeve parlamentare. Ndaj tij janë parashtruar gjithsej 34 pyetje parlamentare, që i bie rreth 40% e shumës së përgjithshme të pyetjeve.

21 nga gjithsej 34 pyetjeve parlamentare drejtuar kryeministrit, janë parashtruar nga deputetët e grupit parlamentar të LVV-së, 8 nga ata të PDK-së, 4 nga AAK dhe vetëm 1 nga partia e kryeministrit (LDK). Sidoqoftë, kryeministri nuk është treguar fare llogaridhënës ndaj deputetëve, duke qenë se është përgjigjur vetëm në 6 nga 34 pyetjet drejtuar atij. Ai i është përgjigjur në 4 prej 8 pyetjeve të deputetëve të grupit parlamentar të PDK-së, 1 prej 21 pyetjeve të LVV-së, pyetjes së vetme të LDK-së, kurse nuk është përgjigjur në asnjë nga 4 pyetjet e parashtruara nga deputetët e grupit parlamentar të AAK-së.

Grafikoni 8. Pyetjet drejtuar Kryeministrit




Sa i përket përgjigjeve të dhëna nga anëtarët e tjera të kabinetit qeveritar, përpos kryeministrit Isa Mustafa, nga 139 pyetjet tjera drejtuar tyre, përgjigje kanë marrë vetëm gjysma e tyre, apo më konkrektisht 70 sosh. Ministrat me më së shumti përgjigje janë Arsim Bajrami me 17 përgjigje nga gjithsej 22 pyetje të adresuara ndaj tij, Arban Abrashi me 12 përgjigje në 20 pyetje dhe Lutfi Zharku me 11 përgjigje nga 12 pyetje drejtuar atij.

Kurse ministrat me më së shumti pyetje të refuzuara janë, Imet Rrahmani me 16 pyetje të refuzuara, Skënder Hyseni me 12 pyetje të refuzuara dhe ministri Blerand Stavileci me 8 pyetje të refuzuara.

Tabela 2. Pyetjet parlamentare drejtuar kabinetit qeveritar

Ministri/ja	Subjekti politik	Pyetje	Përgjigje	Nuk është përgjigjur	Përgjigjet në %	Përqindja e pyetjeve drejtuar ministrit/res
Avdullah Hoti	LDK	9	8	1	89%	11%
Arsim Bajrami	PDK	22	17	5	77%	27%
Enver Hoxhaj	PDK	2	1	1	50%	2%
Lutfi Zharku	LDK	12	11	1	92%	14%
Isa Mustafa	LDK	34	6	28	18%	41%
Edita Tahiri	PDK	2	2	0	100%	2%
Imet Rrahmani	LDK	23	7	16	30%	28%
Hajredin Kuçi	PDK	3	0	3	0%	4%
Kujtim Shala	LDK	6	0	6	0%	7%
Arban Abrashi	LDK	20	12	8	60%	24%
Skender Hyseni	LDK	21	9	12	43%	25%
Dalibor Jevtič	LS	1	1	0	100%	1%
Lubomir Marič	LS	1	0	1	0%	1%
Hykmete Bajrami	LDK	3	1	2	33%	4%
Dhurata Hoxha	PDK	4	1	3	25%	5%
Blerand Stavileci	PDK	8	0	8	0%	10%
Memli Krasniqi	PDK	2	0	2	0%	2%

Grafikoni 9. Përgjigjet dhe refuzimet e qeverisë, sipas grupeve parlamentare



Këtë sesion, pyetje parlamentare kanë parashtruar vetëm 41 deputetë, që i bie se 79 deputetë nuk kanë parashtruar pyetje fare. Prej 41 deputetëve që kanë parashtruar pyetje parlamentare, 13 janë nga PDK, po aq edhe nga LVV (13), 5 nga AAK, 4 nga NPK, 3 nga LDK, 2 nga komunitetet (LS dhe 6+) dhe 1 deputet i pavarur (Margarita Kadriu-Ukelli).

Deputeti me më së shumti pyetje parlamentare gjatë vitit 2016 është Ismajl Kurteshi (29), kurse ata me më së paku pyetje, përveç atyre që nuk kanë bërë pyetje fare (1) janë: Fadil Beka, Rafet Rama, Sala

Berisha-Shala, Salih Morina, Shqipe Pantina, Ali Berisha, Enver Hoti, Haxhi Shala, Danush Ademi dhe Slavko Simić.

Kurse, deputetja me më së shumti pyetje parlamentare për këtë sesion është Besa Baftiu nga LVV me gjithsej 14 pyetje parlamentare.

Tabela 3. Lista e deputetëve që kanë parashtruar pyetje, sipas grupeve parlamentare:

Grupi parlamentar:	Deputeti/ja:	Numri i pyetjeve:
PDK	Abdyl Ymeri	7
	Bekim Haxhiu	5
	Bislim Zogaj	2
	Blerta Deliu-Kodra	4
	Fadil Beka	1
	Ganimete Musliu	7
	Labinotë Demi-Murtezi	2
	Mexhide Mjaku-Topalli	7
	Rafet Rama	1
	Raif Qela	6
	Sala Berisha-Shala	1
	Selvije Halimi	3
	Salihe Mustafa	3
LDK	Alma Lama	5
	Salih Morina	1
	Njomza Emini	2
LVV	Aida Dërguti	4
	Albulena Haxhiu	7
	Besa Baftiu	14
	Donika Kadaj-Bujupi	6
	Driton Çaushti	3
	Faton Topalli	6
	Ismajl Kurteshi	29
	Mytaher Haskuka	7
	Puhie Demaku	2
	Rexhep Selimi	2
	Salih Salihu	5
	Visar Ymeri	3
	Shqipe Pantina	1
AAK	Ali Berisha	1
	Lahi Brahimaj	2
	Time Kadrijaj	3
	Rrustem Berisha	2
	Teuta Haxhiu	4
NPK	Enver Hoti	1
	Haxhi Shala	1

	Shukrije Bytyqi	5
	Zafir Berisha	4
Pa Grup	Margarita Kadriu-Ukelli	2
6+	Danush Ademi	1
LS	Slavko Simič	1

Pyetjet e deputetëve të PDK-së kanë qenë të fokusuara më shumë në sektorin e arsimit dhe çështjeve sociale (6), pyetjet e LDK-së në punë të brendshme (2), të LVV-së po ashtu në punë të brendshme (11) dhe arsim (7), kurse ato të SL-së dhe 6+ në sociale (1) dhe infrastrukturë (1).

Në aspektin gjinor, pyetjet parlamentare shpërfaqin një dominim të lehtë të deputetëve burra, të cilët pijnë në parashtrimin e pyetjeve parlamentare, me 53% të totalit të pyetjeve (91), kurse gratë me 47% të totalit të pyetjeve (82). Po ashtu, edhe nga numri total i deputetëve që kanë parashtruar pyetje (41), prej tyre janë 22 burra dhe 19 gra.

5.2 Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve

Nga viti 2001 e deri më sot Kuvendi ka miratuar gjithsej 682 ligje prej të cilave në fuqi janë 408. Edhe pse planifikimet e aktiviteteve për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve do të duhej të ishin prioritet për Kuvendin respektivisht për Komisionet Parlamentare, iniciativa të tilla kanë munguar gjatë vitit 2016. Komisionet parlamentare kanë për detyrë të mbikëqyrin zbatimin e ligjeve, dhe të hartojnë raporte me rekomandime të cilat i dërgohen Kuvendit për shqyrtim⁴.


Për vitin 2016, në bazë të planeve të punës së komisioneve parlamentare del që është paraparë mbikëqyrja e zbatimit të 37 ligjeve. Aktivitetet në kuadër të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve këtë vit kanë qenë të pakta marrë parasysh faktin që vetëm për gjashtë ligje të mbikëqyrura janë dorëzuar raportet në Kuvend për miratim, nga 37 sa ishin paraparë. Vetëm gjashtë komisione⁵ kanë arritur të mbikëqyrin ligjet e parapara në planet e punës. Ndërkaq në procedurë të mbikëqyrjes kanë mbetur edhe dhjetë ligje të tjera⁶. Ky numër i madh i ligjeve të mbetur pa u mbikëqyrur tregon se komisionet nuk kanë arritur t'i përbushin obligimet e parapara. Performanca e dobët në aspektin e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve vërehet edhe nëse e krahasojmë me vitin 2015 ku ishin planifikuar të mbikëqyrjen 29 ligje e janë mbikëqyrur 16 prej tyre që është numër dukshëm më i madh i ligjeve të mbikëqyrura.

⁴Rregullore e Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 73, pika 1.

⁵Komisioni për Integrime Evropiane – një ligj të monitoruar, Ligji i monitoruar është Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së Fituar me Vepër Penale; Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim – një ligj të monitoruar, Ligji për Shërbyesit Civil; Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport – një ligj të monitoruar, ai për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës; Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor – një ligj i monitoruar, atë për Inspektionin Bujqësor; Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Petacione – një ligj të monitoruar i cili ka qenë i vetmi ligj i paraparë të monitorohet. Ligji i monitoruar është Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Tregti dhe Industri – një ligj të monitoruar, atë për Miniera dhe Minierale.

⁶Komisioni për Legislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e AKK-së (3), Komisioni për Buxhet dhe Financa (1), Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Zhvillim Rural (1), Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale (1), Komisioni për Punë të Jashtme (1), Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjensionit Kosovar për Inteligjencë(1), Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së (1). Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport (1).

Grafikoni 10. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve



5.3 Mbikëqyrja e institucioneve të pavarura

Mbikëqyrja e institucioneve të pavarura të themeluara nga Kuvendi⁷ vazhdon të jetë problematikë për organin më të lartë legjislativ. Shqyrtimi i raporteve vjetore të punës së institucioneve të pavarura është mekanizmi i vetëm me të cilën Kuvendi mban nën mbikëqyrje dhe llogaridhënës këto institucione.

Komisionet parlamentare si trupa punues të Kuvendit, shqyrtojnë raportet vjetore të institucioneve të pavarur që bien në fushëveprimin e tyre dhe të njëjtit i procedojnë në seancë plenare për miratim. Në lidhje me këtë duhet theksuar se edhe në rastet kur Kuvendi nuk i miraton raportet e institucioneve të pavarura, ato nuk sanksionohen për shkak se legjislacioni i aplikueshëm nuk parashev ndonjë procedurë apo masë ndëshkimore për rastet e tillë.

Nga gjithsej 15 komisione, 7 prej tyre kanë shqyrtuar raportet vjetore të organeve të pavarura, kurse gjithsej janë shqyrtuar 20 raporte vjetore të këtyre institucioneve për vitin paraprak. Ndërsa Komisioni për Buxhet dhe Financa përveç shqyrtimit të raporteve vjetore të linjës ka shqyrtuar në aspektin finansiar të gjitha raportet tjera të shqyrtuara paraprakisht nga komisionet funksionale.

Kuvendi i Kosovës deri më tani ka themeluar gjithsej 36 institucione të pavarura⁸ të cilat dallojnë për nga mënyra e funksionimit. Nga këto 36 institucione të pavarura, 29 prej tyre kanë bordin si të vetmin organ me kompetenca ekzekutive, përderisa shtatë organe të tjera mund të funksionojnë edhe pa bord.

Gjatë këtij sesioni, Kuvendi ka zgjedhur gjithsej 20 anëtarë të bordeve të institucioneve të pavarura dhe dy kryesues të bordeve të caktuara. Ndërsa kanë dështuar të zgjedhin anëtarët e tri bordeve të tjera.⁹ Përveç anëtarëve të bordeve, Kuvendi gjithashtu këtë sesion ka zgjedhur edhe drejtorët e dy institucioneve të pavarura, të Agjencisë Kundër Korruptionit dhe Autoritetit Rregullativ të Shërbimeve të Ujit dhe zëvendësdrejtorin e këtij të fundit.

⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 142, pika 1.

⁸ Kjo informatë është marrë në ueb – faqen zyrtare të Kuvendit të Kosovës: <http://eeë.assembly-kosova.org/?cid=1,1044>.

⁹ Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Bordit Këshillëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit.

Politizimi i procesit të emërimit të anëtarëve të bordeve të institucioneve të pavarura është një nga sfidat më të mëdha. Me qëllim të depolitizimit dhe departizimit të këtij procesi, me 15 gusht të këtij viti është nënshkruar edhe një memorandum i bashkëpunimit mes Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës me Ambasadën e Britanisë së Madhe.¹⁰ Kjo marrëveshje bashkëpunimi kishte paraparë krijimin e një trupe të jashtme (kompani konsulente) që do të ndihmonte në aspektin teknik procesin e përzgjedhjes për 20 pozita të lira në poste të larta institucionale, përfshirë anëtarë të bordeve të institucioneve të pavarura. Ndonëse ishte paraparë që ky projekt të përfundonte në mars të vitit 2017, por deri më tanë projekti nuk është zbatuar fare.

5.4 Interpelancat

Një nga format e ushtrimit të funksionit mbikëqyrës të Kuvendit ndaj Qeverisë janë edhe interpelancat parlamentare. Në vitin 2016, Kuvendi ka mbajtur dy interpelanca, të cilat janë drejtuar ndaj kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa dhe që të dyja janë iniciuar nga grupei parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje. Interpelanca e parë është bërë me kërkësë të deputetit Visar Ymeri, i mbështetur edhe nga 7 deputetë të tjerë, në lidhje me Kodin Telefonik Shtetëror të Republikës së Kosovës. Ndërsa interpelanca e dytë është bërë me kërkësë të deputetit Ismajl Kurteshi, i mbështetur edhe nga 10 deputetë nënshkrues, në lidhje me situatën aktuale politike në pjesën veriore të Republikës së Kosovës.

Kërkesa për mbajtjen e këtyre dy interpelancave ishin iniciuar në fund të sesionit pranveror, por ato ishin shtyrë për sesionin vjeshtor meqë ditën kur ishin planifikuara të mbaheshin ishte shqyrtuar edhe Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes për demarkacionin me Malin e Zi.

6. LOJALITETI I DEPUTETËVE NDAJ GRUPEVE PARLAMENTARE

Nga matja e lojalitetit të deputetëve¹¹ të ndara sipas gruive parlamentare, del që grupei parlamentar i LDK-së ka përqindjen më të lartë të lojalitetit prej 96.72%, e pasuar nga grupei parlamentar 6+ me 96%. Me një përqindje pothuajse të njëjtë të lojalitetit me dy grupet parlamentare të lartpërmendura qëndron edhe PDK-ja me 95.51 %. Ndërkohë grupei parlamentar Lista Serbe ka përqindjen më të ulët të lojalitetit në raport me grupet e tjera të partive në pushtet me 91.01%. Shkalla e lojalitetit të deputetëve të partive në pushtet është më e lartë në krahasim me ato në opozitë. Grupei parlamentar i LVV-së vazhdon të mbetet grupei me deputetët më “rebel” nga të gjitha grupet tjera parlamentare me 85 % të lojalitetit, por që edhe dy grupet e tjera parlamentare nga opozita, AAK e NPK kanë përqindje më të ulët të lojalitetit në krahasim me grupet e tjera parlamentare me 92% respektivisht 90.33%.


Kur flasim për matje të lojaliteti është e rëndësishme të përmendet fakti që kjo matje bëhet duke e krahasuar votimin individual të deputetëve më qëndrimin e gruipit parlamentar. Në këtë aspekt,

¹⁰ Memorandumi i Bashkëpunimit i qasshëm në: http://assembly-kosova.org/common/docs/MEMORANDUM_BASHKEPUNIMI_MES_KUVENDIT_TE_REPUBLIKES_SE_KOSOVES_QEVERISE_SE_REPUBLIKES_SE_KOSOVES_DHE_QEVERISE_SE_MBRETERISE_SE_BASHKUAR.pdf

¹¹ Në kuadër të platformës Votalme.org është bërë matja e lojalitetit të deputetëve duke i krahasuar votimet e deputetëve me qëndrimet e gruive të tyre parlamentare. Vlen të theksohet që kjo matje është bërë vetëm në rastet kur ka pasur deklarim të gruipit parlamentar dhe përfshinë të gjitha votimet që nga fillimi i mandatit të Legjislaturës së V-të. Në matjen e lojalitetit nuk janë të përfshirë edhe gjashtë deputetët që janë pa grup parlamentar.

ndonëse LVV- ja prinë për nga niveli i ulët i lojalitetit, ky grup në shumicën e rasteve nuk paraqet një qëndrim të qartë të grüpuit nëse janë për ose kundër një çështje të caktuar.


Grafikoni 11. Lojaliteti i deputetëve ndaj grupeve parlamentare



Nga krahasimi i lojalitetit që nga fillimi i kësaj legislature shohim se grupi parlamentar që ka shënuar më së shumti rritje të lojalitetit për 2% është LDK, kurse grupi parlamentar i LS – së ka pësuar dukshëm ulje të nivelit të lojalitetit për 7%. Grupet e tjera parlamentare (PDK, LVV, 6+) kanë pësuar ndryshime shumë të vogla, ndërsa AAK dhe NPK kanë qenë konsistente në këtë aspekt pasi që prej fillimit të legjislaturës nuk kanë pësuar fare ndryshim në përqindjen e lojalitetit.

Përveç matjes së lojalitetit të deputetëve ndaj grupeve parlamentare, përmes platformës Vota Ime ka vazhduar të bëhet edhe matja e lojalitetit në bazë të gjinisë së deputetëve. Në matjen e lojalitetit sipas gjinisë del që deputetët burra në Kuvendin e Kosovës kanë nivel më të ulët të lojalitetit me 93.10 % për dallim jo shumë të madh nga gratë deputete që janë më lojale ndaj grupit të tyre parlamentar me 94.52 %.

Grafikoni 12. Lojaliteti sipas gjinisë



7. REKOMANDIMET

KDI në raportet paraprake të vlerësimit të punës së Kuvendit të Kosovës ka paraqitur rekondimet të cilat kanë pasur për qëllim adresimin e problemeve të identikuara. Në [Reportin](#) e vlerësimit për sesionin pranveror, kemi dhënë shtatë rekondime për Kuvendit prej të cilave vetëm një është plotësuar, ai për hartimin e planit të punës. Statusi i rekondimeve tjera mbetet i pandryshuar, prandaj të njëjtat rekmandojmë të adresohen nga Kuvendi. Si rekondime të reja, të cilat ia bashkëngjisim rekondimeve paraprake janë:

1. Të parashihen masa sanksionuese për mos pjesëmarrjen e deputetëve në punimet e Kuvendit

Pjesëmarrja e deputetëve në seancat plenare dhe mbledhjet e komisioneve ka qenë një prej sfidave më të mëdha që ka përcjellë këtë legjislaturë. Rregullorja e Kuvendit nuk parasheh masa sanksionuese për deputetët të cilët pa arsy nuk marrin pjesë në punën e Kuvendit, apo nuk qëndrojnë deri në fund të punimeve. Me përjashtim nëse mungesa pa arsy është më e gjatë se gjashtë muaj. Për ta tejkular këtë dukuri, rekandojmë që Rregullorja e Kuvendit të parasheh masat sanksionuese për mungesat e deputetëve pa arsy, apo që kjo të adresohet përmes Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit.

2. Raportimi me kohë i shpenzimeve të Kuvendit

Kuvendi i Kosovës duhet të jetë lider në promovimin e transparencës dhe menaxhimin e parasë publike. Ndonëse në këtë drejtimi ishin shënuar hapa pozitiv, sidomos sa i përket publikimi më të detajuar të shpenzimeve dhe në formate të ri-përpunueshme, për vitin 2016 Kuvendi ka shënuar regres duke mos publikuar raportin vjetor të shpenzimeve. Kuvendi duhet të jetë i rregullt në raportimeve e veta dhe ato duhet të bëhen në mënyrë sa më të detajuar.

3. Hapja e faqes së Kuvendit në rrjetet sociale

Me qëllim të rritjes së transparencës së Kuvendit dhe komunikimit sa më efektiv, duke depërtuar tek një audiencë më e gjerë dhe e re në moshë, rekandojmë që Kuvendi të ndjek zhvillimet e reja dhe të bëjë hapjen e profileve të saj në rrjetet e ndryshme sociale të cilat kanë përdorim edhe në Kosovë.

4. Harmonizimi i profileve të deputetëve

Ueb faqja e Kuvendit përban profilet e deputetëve por që të dhënat e ofruara nuk janë të harmonizuar për të gjithë deputetët. Për disa prej tyre janë paraqitur më shumë të dhëna, si përvoja e punës apo shkollimi, për disa të tjerë janë vetëm të dhënat personale si emri dhe mbiemri. Përveç harmonizimit, në profilet e deputetëve duhet të paraqiten edhe votimet individuale, pyetjet parlamentare, amandamentet e propozuara dhe të dhëna të tjera me rëndësi dhe që pasqyrojnë punën e deputetit.

ANEKS 1: PJESËMARRJA E DEPUTETËVE NË MBLEDHJET E KOMISIONEVE PARLAMENTARE

Komisioni për Buxhet dhe Financa			
Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Vonesa/Daljet e parakohshme	Mungesa
Naser Osmani	32	0	0
Safete Hadërgjonaj	28	2	4
Jelena Bontić*	13	2	17
Adem Grabovci*	16	2	6
Besa Gaxheri	31	1	1
Fikrim Damka	26	3	6
Shqipe Pantina*	12	0	2
Labinotë Demi-Murtezi	32	5	0
Bardhyl Metaj*	24	3	4
Enver Hoti	9	0	23
Bali Muharremaj	7	1	25
Ilir Deda*	0	0	18
Shukri Buja*	9	0	1
Salih Morina*	4	0	0

*Deputeti Adem Grabovci është zëvendësuar me deputetin Shukri Buja më 5 gusht

* Deputeti Bardhyl Metaj është zëvendësuar nga deputeti Salih Morina më 23 nëntor

*Deputeti Ilir Deda është zëvendësuar nga deputetja Shqipe Pantina më 21 qershori

*Deputetja Jelena Bontić ka qenë në pushim të lehonisë që nga muaji qershori

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim			
Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Vonesa/Daljet e parakohshme	Mungesa
Jasmina Živković	22	0	11
Agim Çeku	24	1	9
Müfera Şinik	24	2	9
Fisnik Ismaili	6	2	27
Rrustem Berisha*	0	/	23
Milka Vuletič	20	2	13
Slavko Simić	15	2	18
Veton Berisha	26	2	7
Danush Ademi	29	2	4
Agim Kikaj	20	5	3
Çerim Bajrami	25	0	8
Saša Milosavljević	21	0	12
Ali Berisha*	8	0	2
Kimete Bytyqi*	10	0	1

*Deputeti Rrustem Berisha është zëvendësuar nga deputeti Ali Berisha pas mbledhjes së datës 19 shtator

*Deputeti Agim Kikaj është zëvendësuar nga deputetja Kimete Bytyqi pas mbledhjes së datës 19 shtator

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e AKK-së

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Vonesa/Daljet e parakohshme	Mungesa
Albulena Haxhiu	17	0	23
Selvije Halimi	38	0	2
Danush Ademi	40	1	0
Agim Aliu	39	0	1
Agim Ademaj	37	1	3
Armend Zemaj	39	5	1
Donika Kadaj-Bujupi*	0	/	9
Doruntinë Maloku-Kastrati	23	3	17
Milena Milicevic	25	0	15
Nezir Çoçaj	37	1	3
Valdete Bajrami	6	/	34
Pal Lekaj*	9	1	2

**Donika Kadaj - Bujupi ka përfaqësuar grupin parlamentar të AAK-së deri më datë 24 mars*

**Pal Lekaj është emëruar anëtar i këtij komisioni më 22 shtator, duke zëvendësuar deputeten Donika Kadaj Bujupi*

Komisioni për Integrime Evropiane

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Vonesa/Daljet e parakohshme	Mungesa
Teuta Sahatqija*	6	0	2
Valdete Bajrami	3	2	22
Slobodan Petrovic	10	2	15
Xhavit Haliti	17	2	8
Rrustem Mustafa*	0	0	3
Luljeta Veselaj - Gutaj*	13	0	0
Vjosa Osmani	17	1	8
Arben Gashi	20	7	5
Ilir Deda*	4	0	6
Time Kadrijaj	10	0	15
Kujtim Paçaku	14	0	11
Bislim Zogaj*	22	1	0
Njomza Emini*	16	0	2
Donika Kadaj-Bujupi*	13	2	2
Fatmir Xhelili*	12	0	0

**Deputetja/kryetarja Teuta Sahatqija është zëvendësuar nga deputetja Njomza Emini pas mbledhjes së tetë (8)*

**Deputeti Rrustem Mustafa është zëvendësuar nga deputeti Bislim Zogaj pas mbledhjes së tretë(3)*

**Deputeti Ilir Deda është zëvendësuar nga deputetja Donika Kadaj-Bujupi pas mbledhjes së dhjetë (10)*

**Deputetja Luljeta Veselaj-Gutaj është zëvendësuar nga deputeti Fatmir Xhelili pas mbledhjes së trembëdhjetë (13)*

Komisioni për Punë të Jashtme			
Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Vonesa/Daljet e parakohshme	Mungesa
Enver Hoxhaj*	5	/	1
Teuta Rugova	9	/	10
Cerim Bajrami	12	1	7
Blerta Deliu Kodra	16	/	3
Elmi Reçica	18	/	1
Ismet Begiri	14	5	5
Glauk Konjufca*	2	/	4
Zafir Berisha	11	3	8
Puhie Demaku	5	/	8
Luljeta Veselaj-Gutaj*	9	/	1
Pal Lekaj*	9	1	0

*Deputeti Enver Hoxhaj është zëvendësuar me deputeten Luljeta Veselaj-Gutaj më 5 gusht

*Deputeti Pal Lekaj është bërë anëtar i këtij komisioni që nga sesioni vjeshtor i vitit 2016

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport			
Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Vonesa/Daljet e parakohshme	Mungesa
Nait Hasani	40	/	3
Salih Morina	38	13	5
Serdjan Popovic	23	3	20
Bekim Haxhiu	28	11	15
Shpejtim Bulliqi	41	4	2
Ismail Kurteshi	19	/	4
Shukrije Bytyqi	8	/	35
Mufera Sinik	28	10	15
Teuta Haxhiu	12	/	31

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri			
Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Vonesa/Daljet e parakohshme	Mungesa
Muhamed Mustafa	44	0	3
Visar Ymeri*	0	/	21
Saša Milosavljević	27	3	20
Besim Beqaj	37	6	10
Blerim Grainca	39	1	8
Duda Balje	28	11	19
Enver Hoti	17	4	30
Fatmir Rexhepi	33	5	14
Pal Lekaj	2	0	30
Raif Qela	46	2	1
Sala Berisha-Shala	41	8	6
Glauk Konjufca*	5	0	21
Rrustem Berisha*	15	1	0

*Deputeti Visar Ymeri është zëvendësuar nga deputeti Glauk Konjufca pas mbledhjes së tetëmbëdhjetë (18)

*Deputeti Pal Lekaj është zëvendësuar nga deputeti Rrustem Berisha më 22 shtator

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor			
Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Vonesa/Daljet e parakohshme	Mungesa
Fikrim Damka*	3	0	1
Serdjan Popovic	19	4	9
Salih Salihu	11	2	4
Adem Salihaj	28	0	0
Emilija Redzepi	25	2	3
Lahi Brahimaj*	0	0	18
Murat Hoxha	22	2	6
Shaip Muja	25	4	3
Haxhi Shala	9	1	19
Duda Balje*	23	2	1
Time Kadrijaj*	9	2	1

* Deputeti/Kryetari Fikrim Damka është zëvendësuar nga deputetja Duda Balje më 24 shkurt

* Deputeti Lahi Brahimaj është zëvendësuar nga deputetja Time Kadrijaj më 22 shtator

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media			
Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Vonesa/Daljet e parakohshme	Mungesa
Zenun Pajaziti	14	2	0
Sadri Ferati	14	2	0
Kujtim Paçaku	11	0	3
Alma Lama*	7	1	2
Jelena Bontic	8	4	5
Pal Lekaj	1	0	10
Shqipe Pantina	5	1	9
Xhevahire Izmaku	14	1	0
Zafir Berisha	3	1	11
Agim Kikaj*	3	2	1
Lahi Brahimaj*	3	2	0

*Deputeti Pal Lekaj është zëvendësuar me deputetin Lahi Brahimaj më 22 shtator

*Deputetja Alma Lama është zëvendësuar nga deputeti Agim Kikaj më 21 shtator

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së			
Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Vonesa/Daljet e parakohshme	Mungesa
Daut Haradinaj	9	0	2
Fadil Demaku*	14	0	2
Bojan Mitic	11	3	10
Anton Quni	18	3	3
Ganimete Musliu	18	5	3
Nuredin Ibishi	19	0	2
Zafir Berisha	9	0	2
Čerim Bajrami	15	4	6
Rexhep Selimi	11	2	3

*Deputeti Fadil Demaku ka dhënë dorëheqje nga pozita e deputetit më 25 tetor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike			
Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Vonesa/Daljet e parakohshme	Mungesa
Faton Topalli	12	0	0
Ali Sadriu	18	2	2
Fikrim Damka	11	6	7
Naim Fetahu	18	1	2
Synavere Rysha	16	1	4
Hajdar Beqa	18	5	2
Abdyl Ymeri	15	0	5
Enver Hoti	5	2	15
Bali Muharremaj	7	2	13
Duda Balje	2	0	2

* Deputetja Duda Balje është zëvendësuar nga deputeti Fikrim Damka më 24 shkurt

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale			
Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Vonesa/Daljet e parakohshme	Mungesa
Flora Brovina	23	0	1
Njomza Emini*	6	0	4
Fikrim Damka	20	1	6
Adem Hodza	13	1	13
Besa Baftiu	12	1	14
Fadil Beka	24	1	2
Hatim Baxhaku	26	2	0
Shukrije Bytyqi	5	/	21
Time Kadrijaj*	1	/	0
Mirjeta Kalludra*	9	1	10
Ali Berisha*	6	0	5
Nehat Baftiu*	2	0	0

*Deputetja Njomza Emini është zëvendësuar nga deputetja Mirjeta Kalludra më datë 28 prill

*Time Kadrijaj është zëvendësuar me deputetin Ali Berisha më 22 shtator

*Nehat Baftiu ka zëvendësuar deputeten Flora Brovina në dy mbledhjet e fundit të komisionit

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione			
Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Vonesa/Daljet e parakohshme	Mungesa
Lirije Kajtazi	18	2	1
Salihe Mustafa	18	4	1
Nenad Rasić	13	1	6
Mexhide Mjeku-Topalli	19	2	0
Etem Arifi	13	3	6
Mytaher Haskuka	10	1	2
Teuta Haxhiu	7	1	12
Valdete Bajrami*	1	0	11
Kujtim Paçaku	12	0	7
Shukrije Bytyqi*	2	0	2

*Deputetja Valdete Bajrami është zëvendësuar nga deputetja Shukrije Bytyqi në fund të muajit shtator

Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare për Intelegjencë			
Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Vonesa/Daljet e parakohshme	Mungesa
Duda Balje	7	/	2
Rafet Rama	7	/	2
Nuredin Lushtaku	6	/	3
Milazim Haliti	8	/	1
Melihate Tërmkollı	8	/	1
Adem Hodža*	2	/	2
Nenad Rasić*	4	/	1
Aida Dërguti	2	/	7
Haxhi Shala	2	/	7
Rrustem Berisha	2	/	7

*Deputeti Nenad Rasić është zëvendësuar nga deputeti Adem Hodža më 9 qershori

Komisioni parlamentar për Stabilizim-Asociim			
Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Vonesa/Daljet e parakohshme	Mungesa
Xhavit Haliti	8	/	0
Sabri Hamiti	8	/	0
Adem Grabovci	7	1	1
Donika Kadaj - Bujupi	5	1	3
Ismet Beqiri	8	1	0
Kujtim Paçaku	5	/	3
Valdete Bajrami	8	1	0
Muhamed Mustafa	6	1	2
Nenad Rasic	5	/	3
Selvije Halimi	8	1	0
Time Kadrijaj	7	1	1
Visar Ymeri	4	/	4
Slobodan Petrović	1	/	7
Pal Lekaj	5	1	3
Luljeta Veselaj-Gutaj	0	/	8

ANEKS 2: PJESËMARRJA E DEPUTETËVE NË SEANCA

Emri dhe Mbiemri	Grupi parlamentar	Numri i seancave sipas muajve												Pjesëmarrje	Mungesa
		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor (1 vazhdim)	Nëntor	Dhjetor (3 vazhdime)		
Abdyl Ymeri	PDK	-	4	2	2	3	4	2	3	5	2	6	33	0	
Ali Sadriu	LDK	3	4	2	2	3	4	2	3	5	2	6	36	0	
Milazim Haliti	LDK	3	4	2	2	3	4	2	3	5	2	6	36	0	
Luljeta Veselaj – Gutaj	PDK	3	4	2	2	3	4	2	3	5	2	6	36	0	
Mexhide Mjaku - Topalli	PDK	3	4	2	2	3	4	2	3	5	2	6	36	0	
Sabri Hamiti	LDK	3	4	2	2	3	4	2	3	5	2	6	36	0	
Teuta Sahatqija	LDK	3	4	-	-	-	-	-	-	-	-	-	7	0	
Zenun Pajaziti	PDK	3	4	2	2	3	4	2	3	5	2	6	36	0	
Kimete Bytyqi	LDK	-	-	-	-	-	-	-	3	5	2	6	16	0	
Nehat Baftiu	PDK	-	-	-	-	-	-	-	-	-	2	6	8	0	
Adem Grabovci	PDK	2	4	2	2	3	4	2	3	5	2	6	35	1	
Agim Ademaj	LDK	3	4	2	2	3	4	2	3	4	2	6	35	1	
Armend Zemaj	LDK	3	4	2	1	3	4	2	3	5	2	6	35	1	
Besa Gaxherri	LDK	3	4	2	1	3	4	2	3	5	2	6	35	1	
Bislim Zogaj	PDK	3	4	2	2	3	4	2	2	5	2	6	35	1	
Emilija Redzepi	PDK	3	4	2	2	3	4	1	3	5	2	6	35	1	
Fadil Beka	PDK	3	4	2	2	3	3	2	3	5	2	6	35	1	

Flora Brovina	PDK		3	4	2	2	3	4	2	3	5	2	5	35	1
Labinotë Demi – Murtezi	PDK		3	4	2	2	3	4	2	3	5	1	6	35	1
Lirije Kajtazi	LDK		3	4	2	1	3	4	2	3	5	2	6	35	1
Fikrim Damka	6+		3	4	2	2	3	4	2	3	5	1	6	35	1
Muhamed Mustafa	LDK		3	4	2	2	3	4	2	2	5	2	6	35	1
Raif Qela	PDK		3	4	2	2	3	3	2	3	5	2	6	35	1
Selvije Halimi	PDK		3	4	2	1	3	4	2	3	5	2	6	35	1
Fatmir Shurdhaj	PDK		-	-	-	-	-	-	-	-	-	2	5	7	1
Adem Salihaj	LDK		2	4	2	2	3	4	2	3	5	1	6	34	2
Anton Quni	LDK		2	4	2	2	3	4	2	2	5	2	6	34	2
Azem Syla	PDK		3	4	0	-	-	-	-	-	-	-	-	7	2
Blerta Deliu-Kodra	PDK		2	3	2	2	3	4	2	3	5	2	6	34	2
Salihe Mustafa	PDK		3	4	2	2	3	3	2	2	5	2	6	34	2
Nait Hasani	PDK		3	4	2	0	3	4	2	3	5	2	6	34	2
Hatim Baxhaku	LDK		2	4	2	2	3	3	2	3	5	2	6	34	2
Kujtim Paçaku	6+		3	4	2	2	3	4	2	2	5	2	5	34	2
Agim Kikaj	LDK		3	3	2	1	3	4	2	3	5	2	6	34	2
Melihate Tërmkollı	LDK		3	4	2	2	3	4	2	3	5	2	4	34	2
Nuredin Ibishi	LDK		3	3	2	2	3	3	2	3	5	2	6	34	2
Shpejtim Bulliqi	LDK		2	4	2	1	3	4	2	3	5	2	6	34	2
Veton Berisha	LDK		3	3	2	2	3	4	2	2	5	2	6	34	2
Agim Aliu	PDK		3	3	2	2	3	2	2	3	5	2	6	33	3
Alma Lama	LDK		3	3	2	1	2	4	-	-	-	-	-	15	3
Bekim Haxhiu	PDK		3	4	2	1	2	4	2	3	4	2	6	33	3
Elmi Reçica	PDK		3	3	2	2	3	4	2	3	3	2	6	33	3
Fatmir Xhelili	PDK		-	-	-	-	2	4	2	2	5	2	5	22	3
Ismet Beqiri	LDK		3	3	2	2	3	3	2	3	5	2	5	33	3
Mirjeta Kalludra	LDK		-	-	-	2	3	3	2	3	5	2	4	24	3
Naim Fetahu	PDK		3	3	2	2	3	3	2	3	5	1	6	33	3
Ramush Haradinaj	AAK		0	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0	3

Cerim Bajrami	6+		3	3	2	1	3	4	2	3	5	2	5	33	3
Safete Hadërgjonaj	PDK		3	4	2	2	2	4	0	3	5	2	6	33	3
Salih Morina	LDK		2	3	2	1	3	4	2	3	5	2	6	33	3
Shukri Buja	PDK		-	-	-	-	0	4	2	3	5	2	6	22	3
Teuta Rugova	LDK		3	3	2	2	3	4	1	2	5	2	6	33	3
Xhevahire Izmaku	PDK		3	4	2	2	3	4	2	2	3	2	6	33	3
Danush Ademi	6+		3	4	2	1	2	4	2	3	5	1	5	32	4
Doruntinë Maloku - Kastrati	LDK		3	4	2	0	3	4	2	3	5	1	5	32	4
Etem Arifi	LDK		3	3	2	1	3	4	2	3	4	1	6	32	4
Shaip Muja	Pa Grup		2	4	2	1	3	3	2	3	5	2	5	32	4
Kadri Veseli	PDK		3	2	2	2	3	4	2	3	5	1	5	32	4
Hajdar Beqা	PDK		3	4	2	2	3	3	2	3	4	2	4	32	4
Mufera Srbica - Sinik	6+		2	4	2	2	3	4	2	3	5	1	4	32	4
Arben Gashi	LDK		2	4	2	2	3	3	2	2	3	2	6	31	5
Blerim Shala	Pa Grup		3	4	2	1	3	3	2	3	4	2	4	31	5
Synavere Rysha	LDK		3	4	2	2	3	0	1	3	5	2	6	31	5
Rafet Rama	PDK		3	4	2	0	3	1	2	3	5	2	6	31	5
Sadri Ferati	LDK		2	4	2	2	3	2	1	3	5	1	6	31	5
Sala Berisha - Shala	PDK		3	3	2	2	3	3	2	3	3	2	5	31	5
Enver Hoxhaj	PDK		3	1	0	1	-	-	-	-	-	-	-	5	6
Gëzim Kelmendi	Pa Grup		2	2	2	1	3	4	1	3	5	2	5	30	6
Nezir Çoçaj	PDK		3	4	2	2	3	2	1	3	2	2	6	30	6
Agim Çeku	PDK		3	3	2	1	2	3	2	3	4	2	4	29	7
Fadil Demaku	PDK		3	4	2	1	0	4	2	2	3	-	-	21	7
Blerim Grainca	LDK		3	4	2	1	3	1	2	3	3	2	5	29	7
Driton Çaushi	LVV		-	-	-	0	0	4	2	3	5	2	4	20	7
Duda Balje	6+		3	3	2	0	3	4	1	3	4	2	4	29	7
Ganimete Musliu	PDK		2	4	2	2	2	4	2	3	5	2	1	29	7
Murat Hoxha	LDK		3	3	1	1	3	4	1	2	5	1	5	29	7
Naser Osmani	LDK		3	4	1	1	3	3	0	3	4	2	4	28	8

Njomza Emini	LDK		3	4	1	0	0	4	2	2	4	2	6	28	8
Vjosa Osmani - Sadriu	LDK		0	3	2	2	2	3	2	2	5	1	6	28	8
Besnik Bislimi	LVV		0	0	0	-	-	-	-	-	-	-	-	0	9
Fatmir Rexhepi	LDK		3	2	1	1	3	2	2	2	4	2	5	27	9
Nuredin Lushtaku	PDK		3	3	1	1	3	2	1	2	5	2	4	27	9
Besim Beqaj	PDK		3	4	1	1	3	1	2	3	3	2	3	26	10
Bardhyl Meta	LDK		3	4	0	1	3	4	2	3	5	0	0	25	11
Ismajl Kurteshi	LVV		0	1	0	0	2	4	2	3	5	2	5	24	12
Margarita Kadriu	Pa Grup		2	4	2	1	1	2	0	3	4	2	3	24	12
Ramiz Kelmendi	Pa Grup		2	3	1	0	2	2	1	3	2	-	-	16	12
Xhavit Haliti	PDK		3	2	2	2	3	2	2	2	1	2	3	24	12
Besa Baftiu	LVV		0	1	0	0	3	4	2	3	4	2	4	23	13
Bojan Mitić	LS		3	4	2	0	3	4	2	2	1	0	2	23	13
Milena Miličević	LS		3	4	2	1	3	4	2	2	1	0	1	23	13
Milka Vuletić	LS		3	4	2	1	3	4	2	2	1	0	1	23	13
Slavko Simić	LS		3	4	2	0	3	4	2	2	1	0	2	23	13
Visar Ymeri	LVV		0	0	0	0	2	4	2	3	5	2	5	23	13
Donika Kadaj - Bujupi	LVV		0	1	0	0	2	4	2	1	5	2	5	22	14
Nenad Rashiq	LS		3	4	2	1	3	3	2	2	1	0	0	21	15
Rexhep Selimi	LVV		0	1	0	0	0	4	2	3	5	2	5	22	14
Mytaher Haskuka	LVV		0	0	0	0	3	4	1	3	5	1	4	21	15
Aida Dërguti	LVV		0	1	0	0	3	2	1	3	3	2	5	20	16
Ali Berisha	AAK		-	1	0	0	0	0	0	3	5	2	6	17	16
Glauk Konjufca	LVV		0	0	0	0	3	3	2	2	4	2	4	20	16
Salih Salihu	LVV		1	2	0	0	3	3	2	3	4	0	2	20	16
Shqipe Pantina	LVV		0	0	0	0	3	3	0	3	5	2	4	20	16
Albulena Haxhiu	LVV		0	0	0	0	2	3	2	3	3	2	4	19	17
Fisnik Ismajli	LVV		0	1	0	0	1	2	2	3	4	2	4	19	17
Jasmina Živković	LS		3	4	1	1	3	4	2	1	0	0	0	19	17
Saša Milosavlević	LS		3	4	1	0	3	3	1	2	1	0	1	19	17

Srdjan Popoviq	LS	3	4	1	1	3	2	2	2	1	0	0	19	17
Albin Kurti	LVV	0	0	0	0	1	1	2	3	5	1	5	18	18
Faton Topalli	LVV	0	0	0	0	3	2	0	3	5	2	3	18	18
Slobodan Petrović	LS	2	4	1	1	3	3	0	1	1	0	2	18	18
Teuta Haxhiu	AAK	1	1	0	0	0	0	0	3	5	2	6	18	18
Adem Hodža	LS	2	4	1	1	3	2	1	2	1	0	0	17	19
Lahi Brahimaj	AAK	0	1	0	0	0	0	0	3	5	2	6	17	19
Puhie Demaku	LVV	0	1	0	0	2	3	2	3	1	2	3	17	19
Shukrije Bytyqi	NISMA	0	1	0	0	0	0	0	3	5	2	6	17	19
Pal Lekaj	AAK	0	1	0	0	0	0	0	3	4	2	6	16	20
Rrustem Berisha	AAK	0	1	0	0	0	0	0	3	5	2	5	16	20
Zafir Berisha	NISMA	1	1	0	0	0	0	0	3	5	2	4	16	20
Bali Muharremaj	AAK	0	1	0	0	0	0	0	3	5	1	5	15	21
Haxhi Shala	NISMA	0	1	0	0	0	0	0	2	5	2	5	15	21
Ilir Deda	Pa Grup	0	1	0	0	0	0	0	3	5	1	5	15	21
Enver Hoti	NISMA	0	1	0	0	0	0	0	3	4	2	5	15	21
Time Kadrijaj	AAK	0	0	0	0	0	0	0	2	5	2	6	15	21
Daut Haradinaj	AAK	0	1	0	0	0	0	0	2	3	2	6	14	22
Jelena Bontić	LS	3	3	1	1	3	0	0	1	0	0	0	12	24
Valdete Bajrami	NISMA	0	1	0	0	0	0	0	2	3	1	5	12	24
Fatmir Limaj	NISMA	3	1	0	0	0	0	0	1	2	1	0	8	28

ANKES 3: Pyetjet parlamentare sipas sektorëve

Deputeti/ja	Grupi parlamentar	Dialogu	Financa	Tregti	Ekonomi	Punë të Jashtme	Infrastrukturë	Aviacon	Komunikacion	Migrim/Kthim	Qeverisje Lokale	Energetikë	Anti-Korruption	Ambient	Siguri	Drejtësi	Shëndetësi	Arsim	Administratë	Metalurgji	Sport	Kulturë	Bujqësi	Drejta të Njeriut	P. brendshme	Sociale	Gjithsej	Përgjigjur
Abdyl Ymeri	PDK			1			1		1									1			1	1			7	3		
Bekim Haxhiu	PDK			1			1											1				1			5	1		
Bislim Zogaj	PDK																	1							2	2		
Blerta Deliu-Kodra	PDK																1								3	1		
Fadil Beka	PDK																								1	1		
Ganimete Musliu	PDK	1						1								2		2							7	5		
Labinotë Demi-Murtezi	PDK																1		1						1	2		
Mexhide Mjaku-Topalli	PDK		2													1		1							3	7		
Rafet Rama	PDK	1																								1	0	
Raif Qela	PDK	1			1													3							1	6		
Sala Berisha-Shala	PDK						1																			1		
Selvije Halimi	PDK						1									2										3		
Salihe Mustafa	PDK						1									1									1	3		

Alma Lama	LDK										1			1					1	2			5	4		
Salih Morina	LDK																		1				1	0		
Njomza Emini	LDK																					1	2	1		
Aida Derguti	LVV																				2	1	4	1		
Albulena Haxhiu	LVV										1			1							2	1		7	2	
Besa Baftiu	LVV																	11	3					14	6	
Donika Kadaj-Bujupi	LVV	1	1																		3	1		6	1	
Driton Caushi	LVV									1												1		3	0	
Faton Topalli	LVV	1																				5		6	2	
Ismajl Kurteshi	LVV	7		1	1				1		1							2		5	2		4	5	29	10
Mytaher Haskuka	LVV		1						1		1							1			1	1		7	3	
Puhie Demaku	LVV							2																	2	1
Rexhep Selimi	LVV	1																							2	2
Salih Salihu	LVV							1			1		1							2				5	2	
Visar Ymeri	LVV																		1			2		3	0	
Shqipe Pantina	LVV																	1						1	0	
Ali Berisha	AAK							1																1	1	
Lahi Brahimaj	AAK	1							1															2	0	

Time Kadrijaj	AAK														2						1				3	1		
Rrustem Berisha	AAK																1						1	2	0			
Teuta Haxhiu	AAK															1	2						1	4	2			
Enver Hoti	NPK																					1	1	1	1			
Haxhi Shala	NPK																	1						1	0			
Shukrije Bytyqi	NPK														1		4							5	1			
Zafir Berisha	NPK			2																		2		4	2			
Margarita Kadriu- Ukelli	Pa Part i				1												1							2	0			
Danush Ademi	6+																							1	1			
Slavko Simic	SL																						1	1	1			
Gjithsej pyetje		14	6	4	4	2	10	3	1	1	1	2	2	1	5	7	24	19	3	4	3	2	4	9	22	20	173	76